| Vit i ifin anc | Honor arest udimi (zëri 230) | Shpe nz. Udh ët. (zëri 230) | Shërb . tëtr etët (zëri 230) | Shpe nz. Tran sp. (zëri 230) | Shpe nz. Të tjera oper at. (zëri 230) | Total i (zëri 230) | Pajisj e (zëri 231) | Gjiths ej | Kërk . Nga PKK ZH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 75 | 5 | 5 | 5 | 3 | 93 | 12 | 1.05 | |
| 2 | 75 | 5 | 10 | 5 | 6 | 1 01 | 4 | 1.05 | |
| 3 | 15 | 5 | 10 | 5 | 6 | 101 | 4 | 1.05 | |
| 4 | 15 | 5 | 5 | 5 | 10 | 50 | 0 | 40 | |
| 5 | 15 | 5 | | | | 20 | 0 | 20 | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | Gjithsej : | 3.75 | |

*11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese)personjuridik?* Po

*12. Kur ështëipregatiturInstitucionitëfillojëProjektin?Shtator 2021*

*13. Cilatjanërisqet e mundëshmedhesi do tëkapërcehen?Zgjatja e pandemisëqë do kapërcehet me takimetdhembledhjet on-line*

Drejtuesi iGrupitKërkimor

Prof. Dr.AnilaNeziri

Firma Data: 16.06.2021

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. As. Dr. Mirjam Dibra

Firma Data:16/06/2021

Nr: 2271 prot
dt. 21. 07. 2021

Republika e Shqiperisë
Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Dekani

Nr. 550 prot. Shkodër, me 19/07/2021

**Lënda:** Kërkesë për miratimin e projektit kärkimor shkencor dhe të zhvillimit për Programin e Studimeve Doktorale në "Shkencat Mjedisore" në përputhje me ndryshimet e akteve ligjore në fuqi

**Drejtuar:** Rektores së USH, Prof. Dr. Suzana GOLEMI
Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Në mbështetje të ligiit me Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; të Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Natyrës të USH dhe në mbështetje të kërkesave të VKM nr. 185 datë 25.3.2021 mbi "Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24. 01. 2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL të ndryshuar", dhe udhëzimit MASR nr. 7 datë 31.3.2021 mbi "Disa ndryshime në udhézimin nr. 1, date 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, të ndryshuar" përcjellim për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", projektet kërkimore dhe të zhvillimit për prgramin e studimeve doktorale në "Shkencat Mjedisore"

Bashkëngjitur kësaj shkrese:

1. Vendimi i Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë drejtuar Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
2. Përmbledhësja e projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit së bashku me projektet përkatëse.

DEKANI
Prof. as. dr. Rrok Smajlaj

Republika e Shqiperisë
Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
D e k a n i

Nr. 548 prot.

Shkodër, me 19/07/2021

**Lenda:** Miratimi i vendimit Nr. 1, datë 16.07.2021, të Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë, per Projektet kerkimore shkencore dhe te zhvillimit ne mbeshtetje të Programit të Studimeve Doktorale në "Shkenca Mjedisore"

Në mbështetje të ligiit me Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; të Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Natyrës të USH, të kërkesave të VKM nr. 185 datë 25.3.2021 mbi "Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL të ndryshuar, dhe udhëzimit të MASR nr. 7 datë 31.03.2021 mbi disa ndryshime në udhëzimin nr. l, date 14.01.2020, për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, të ndryshuar":

**Miratoj** kërkesen e Departamentit te Biologjise dhe Kimise, nr. 27 prot. të datës 16.07.2021, për projektet kërkimore shkencore dhe të zhvillimit, ne mbeshtetje të Programit të Studimeve Doktorale në "Shkenca mjedisore".

DEKANI
Prof. Asoc. Brok Smajlaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I SHKODRËS "*Luigj Gurakuqi*"**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**
**DEPARTAMENTI BIOLOGJI KIMI**

Programi i doktoratures : " Shkenca Mjedisore"

PERMBLEDHESE E PROJEKTEVE KËRKIMORE SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT

| Nr. | Titulli i projektit | Drejtuesi sheknco r i Projektit | Shuma qe kerkohet te financohet nga buxheti i UNISHK (ne Mije leke) |
|---|---|---|---|
| 1 | Menaxhimi i integruar i biodiversitetit dhe burimeve ujore të lumit Drin | Prof. As. Dr. Violeta Alushi | 5200 |
| 2 | Vlerësimi i ndikimit të HECE-ve mbi florën dhe faunën ujore në pellgun e lumenjve të Cemit dhe të Valbonës" | Prof. As. Dr. Marash Rakaj | 7750 |
| 3 | Ekotoksikologji dhe aspekte te kimise e biokimise mjedisore | Prof.Dr.Anila Neziri | 6800 |
| GJITHSEJ PER T'U FINANCUAR NGA UNISHK | | | 19750 |

*Përgjegjëse e Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë*

*Prof. As. Ariana Striniqi*

*Dekan i FShN*

*Prof. As. Rrok Smajlaj*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I SHKODRËS "*Luigj Gurakuqi*"**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**
**DEPARTAMENTI BIOLOGJI-KIMI**

Nr. 27 prot. *Shkodër, më 16. 07.2021*

**VENDIM**

**Nr. 1 date 16.07.2021**

**Lënda:** Mbi miratimin e draft-projekteve kerkimore dhe te zhvillimit te programit te studimit te Doktorature ne" Shkenca Mjedisore" ne perputhje me ndryshimet e akteve ligjore ne fuqi.

**Drejtuar:** Dekanit te F.SH.N

Në mbështetje të ligiit me Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë "; të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; të Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Natyrës të USH, të Rregullores së Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë (Qendrë së Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës të FSHNUNISHK, dhe bazuar në VKM nr. 185 datë 25.3.2021 mbi "Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IA të ndryshuar", udhëzimin e MASR nr. 7 datë 31.3.2021 mbi "Disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14. 01. 2020 'Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, të ndryshuar", Departamenti Biologji-Kimi në mbledhjen e datës 16.07.2021, shqyrtoi dhe unanimisht

VENDOSI:

1. Miratimin e draft-projekteve kërkimore shkencore dhe të zhvillimit për programin e stidimeve doktorale në "**Shkenca Mjedisore**" si me poshte:

   - Menaxhimi i integruar i biodiversitetit dhe burimeve ujore të lumit Drin
   - Vlerësimi i ndikimit të HECE-ve mbi florën dhe faunën ujore në pellgun e lumenjve të Cemit dhe të Valbonës"
   - Ekotoksikologji dhe aspekte te kimise e biokimise mjedisore

(Bashkëngjitur përmbledhja e projekteve dhe draft-projektet përkatëse)

2. Ky vendim i përcillet Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të USH për procedurë të mëtëjshme.

***Përgjegjëse e Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë***

***Prof. As. Dr. Ariana Striniqi***

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, http://www.unishk.edu.al, info@unishk.edu.al

/

# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## "Luigj Gurakuqi"
### Fakulteti Shkencave te Natyres

## Programi i doktoraturës në "Shkencat Mjedisore"
## DEPARTAMENTI BIOLOGJISË DHE KIMISË
## MODELI- Projekti Kërkimor Shkencor dhe i Zhvillimit

**I. Fusha e Kërkimit Shkencor: Menaxhimi i integruar i biodiversitetit dhe burimeve ujore të Lumit Drin**

**II. Grupi kërkimor-shkencor**: Prof.as.dr. Violeta Alushi (violeta.alushi @unishk.edu.al), Prof.as.dr. Marash Rakaj (marash.rakaj@unishk.edu.al), Prof.dr. Adem Bekteshi (adem.bekteshi@unishk.edu.al), Prof.as.dr. Rrok Smajlaj (rrok.smajlj@unishk.edu.al ), Prof.dr Anila Neziri (anila.neziri@unishk.edu.al) Universiteti i Shkodrës.

**III. Propozuar si pjesë e Prioriteteve Strategjike të UNISHK me Vendim SA nr. 97 nr.1026, prot 29.03.2021, ku "Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve ujore" është vendosur si njëri prej tyre.**

**III. Objektivat e projektit:**

1. Vlerësimi i cilësive kimike të ujërave dhe i ndotjes mikrobiologjike të ujërave.
2. Vlerësimi i cilësive biologjike të ujërave bazuar në specie indikatore.
3. Klasifikimi i statusit ekologjik aktual të lumit (segmenti Fierzë – Vau i Dejës).
4. Mundësimi i menaxhimit të integruar të burimeve ujore të lumit Drin
5. Ruajtja e biodiversitetit dhe e shërbimeve që lumi Drin ofron.
6. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të lumit Drin.

## IV. Personeli i Projektit:

| Emri Mbiemri | Titulli shkencor | Posti që mban | IAL |
|---|---|---|---|
| **Drejtuesi i Grupit Kérkimor** | | | |
| Violeta Alushi | Prof.as.dr. | Lektor | UNISHK |
| Bashkëpunétorë shkencore | | | |
| Adem Bekteshi | Prof.dr. | Lektor | UNISHK |
| Anila Neziri | Prof.dr. | Lektore | UNISHK |
| Rrok Smajlaj | Prof.as.dr. | Lektore | UNISHK |
| Marash Rakaj | Prof.as.dr. | Lektore | UNISHK |

## VI. Argumentimi shkencor i Projektit.

### *A. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

Nga zbatimi i kétij projekti kërkimor-shkencor do të realizohet monitorimi dhe vlerësimi i cilësive fiziko-kimike, kimike, mikrobiologjike dhe biologjike (fitoplanktoni, makrofitet dhe fauna ujore) në segmentin Fierzë-Vau i Dejës të Lumit Drin.

Vlerat që do arrihen nepërmjet analizave të parametrave kimike dhe cilësive biologjike do të shërbejnë pë klasifikimin e ekologjik ujërave të lumit.

Cilësitë fiziko-kimke, kimike, fitoplanktoni (fitobentosi), makrozoobentosi dhe peshqit përbëjnë një nga 4 elementët kryesorë biologjik të vlerësimit dhe të klasifikimit të gjendjes ekologjike të ujërave sipas Direktivës Kornizë të Ujërave (WFD) dhe konventave e direktivave të tjera të Bashkimit Europian.

Hartimi i Raportit Tematik mbi statusin ekologjik të Lumit Drin do të shërbej si model për vlerësimin dhe klasifikimin ekologjik edhe të lumenjve të tjerë të vendit tonë.

Raporti Tematik do të ndihmoi gjithashtu në hartimin e strategjive e programeve kombëtare dhe të planeve të menaxhimit të lumit Drin e më gjerë.

Lumi Drin është lum ndërkufitar, më i gjati në vendin tonë (243 km) dhe një nga më të rëndësishmit në Ballkan.

Ai shtrihet në pjesën veri-lindore të Shqipërisë, në kufijtë me Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Kosovën.

Lumi Drin buron nga Liqeni i Ohrit dhe së bashku me të, Liqenin e Prespës Madhe, Liqenin e Shkodrës dhe Lumin Buna formojnë një kompleks hidrologjik unik për Europën Juglindore.

Mbi Lumin Drin janë ndërtuar 3 diga (HEC-e) të mëdhaja dhe po ndërtohet HEC-i i katërt.

Lumi menaxhohet kryesisht për energinë elektrike, por burimet ujore të pellgut të perdoren për ujë të pishëm, për vaditje, transport, peshkim, turizëm etj.

Lumi menaxhohet kryesisht për energinë elektrike, por burimet ujore të pellgut të perdoren për ujë të pishëm, për vaditje, transport, peshkim, turizëm etj.

Pellgu i Lumit Drin ashtu si edhe krejt Shqipëria, shqhet për potencialet e mëdha natyrore dhe për diversitetin e lartë të florës dhe të faunës dhe për numrin e lartë të endemizmave. Duke marrë në konsideratë vlerat e shumta natyrore të lumit, na rrit përgjegjësitë për mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Ndërtimi i digave e ka tjetërsuar lumin dhe ujërat e tij, duke e transferuar në liqene artificilale me rrjedhje të ngadalshme, veçanërisht gjatë verës. Kjo ka bërë që flora dhe fauna ujore të humbin pjesërisht karakteristikat lumore dhe të marrin ato liqenore. Disa specie peshqish janë zhduk ose janë rralluar shumë etj.

Zhvillimi intensive i ekonomisë dhe i turizmit etj., kanë rritur kërkesën për energji dhe impaktin mbi lumenj. Këto kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm të parametrave hidrike, kimike dhe biologjike të lumit Drin dhe lumenjve të tjerë me synim ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të komponenteve të biodiversitetit, veçanërisht të faunës ujore (peshq etj.).

**Parametrat që do analizohen:**

1. Parametrat fiziko-kimke
2. Parametrat kimike
3. Ndotja mikroiologjike
4. Diatomete bentike
5. Protozoarët
6. Makroinvertebroret bentik
7. Peshqit

**B. Punime të kryera deri tani ose që janë në progres në ketë fushë**


A. PAPARISTO, B. PEPA & M. RAKAJ. 2017: "Enabling Transboundary Cooperation and Integrated Water Resources Management in the Extended Drin River Basin", GEF Project "

A. BEKTESHI & I. LEKA. 2001: "Dynamics of changing of chemical of Shkodra lake water" Journal of Environmental Protection and Ecolog Vol. 2, Nr.3, pp. 632-636.

L. KASHTA, M. RAKAJ & V. ZENELI. 2016: *The diversity of aquatic macrophytes in the transboundary lakes of shkodra, Ohrid and Prespa – Albanian.* Buletini Matematika dhe Shkencat e Natyres Nr.20: 28-39. Botim i Universitetit te Tiranes, Fakulteti i Shkencave te Natyrës.

M. BARBIERI. A GARONE, A. NEZIRI. M. ROSSI: 2015: First groundäater chemical status assessment of the Buna River. Protected Landscape (Albania). Environmental Earth Sciences (Impakt faktor Thomson Scientific IF 2014 1.765). 2015

M. RAKAJ. 2012: Biological Conditions of the Lake Shkodra and Buna River. Journal of Environmental Protection and Ecology 13(3): 1397-1404. SciBultCom Ltd. ISSN: 1311$065. Impact Factor (Thomson Scientific 2011).

M. RAKAJ. 2008: Community of phytoplankton and periphyton as indicators of trophic state of Lake Shkodra. *International Conference on Biological and Environmental Sciences,* Faculty of Natural Sciences, University of Tirana.

M. RAKAJ & DH. DHORA. 2012: Conspicuous Values and Incisive Environmental Problems of Buna River. Journal of Environmental Protection and Ecology 13(3): 1366-1374. SciBullCom Ltd. ISSN: 1311-5065. Impact Factor (Thomson Scientific 2011) = 0.102.

M. RAKAJ & L. KASHTA. 2017: *The diversity and protected status of aquatic tracheophytes in the transboundary lakes of Shkodra, Ohrid and Prespa – Albanian part.* Buletini Shkencor, Seria e Shkencave të Natyrës, nr.67: 67-83.

M. RAKAJ & RR. SMAJLAJ. 2010: Vlerësim paraprak i Statusit Ekologjik të Lumit Buna. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 60:145-154.

M. RAKAJ. & RR. SAMAJLAJ. 2015. *Kontribut mbi implementmin e Direktivës së Habitateve për mjediset ujore të Shqipërisë.* Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 65: 103-116. ISSN 2221-6847.

M. RAKAJ, V. ALUSHI & RR. SMAJLAJ. 2020: Specie aliene të ujërave të ëmbla të Shqipërisë. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 22 ((*në botim*).

V. ALUSHI & M. RAKAJ. 2011: Overview of Protists of the Shkodra Lake. *International Journal of Ecosystems and Eclogy Sciences (IJEES),* vol 1. "Special issue, ICE 2011", p. 1-6. ISBN: 2224-4980.

**C. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombetare të Kërkimit e Zhvillimit):**

ANONIMA: 2020 -2021: *Vlerësimi i cilësisë ekologjike të ujit të ekosistemit ujor të Liqenit të Shkodrës sipas standardeve të BE dhe të Direktivës Kuadër të Ujërave (DKU).* Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës dhe Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë. Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

L. KASHTA & M. RAKAJ. 2018: *Vlerësimi i gjendjes ekologjike të liqeneve Ohër,Prespë dhe Shkodër mbështetur në Indeksin e makrofiteve.* Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 61.

**D. *Objektivi i zhvillimit:* Raporti tematik mbi biodiversitetin dhe ekositemin lumor.**

**E. *Objektivat imediate dhe rezultatet e pritëshme:***

**Objektivi 1: Vlerësimi i cilësive kimike dhe i ndotjes mikrobiologjike të Lumit Drin.**

*Rezultati 1:*

Gjendja e cilësise kimike dhe niveli i ndotjes mikrobiologjike të burimeve ujore të lumit.

*Rezultati 2:*

Hartimi i një raporti të detajuar mbi nivelin e ndotjes kimike dhe mikrobiologjike të Lumi Drin.

**Objektivi 2: Vlerësimi i cilësive biologjike të burimeve ujore bazuar mbi speciet indikatore dhe abundancen e tyre.**

*Rezultati 1:*

Gjendja e cilësieve biologjike të burimeve ujore të lumit.

*Rezultati 2:*

Hartimi i një raporti të detajuar mbi cilësitë biologjike të Lumit Drin.

**Objektivi 3: Klasifikimi i statusit ekologjik aktual të lumit Drin (segmenti Fierzë – Vau i Dejës).**

*Rezultati 1:*

Përshkruani elementëve biologjikë të nevojshëm për vlerësimin e statusit ekologjik te lumit.

*Rezultati 2:*

Klasifikimi i statusit ekologjik aktual të lumit Drin (segmenti Fierzë – Vau i Dejës)

**Objektivi 4: Mundësimi i menaxhimit të integruar të burimeve ujore të lumit Drin.**

*Rezultati 1:*

Konsolidimi i një baze të dhënash mbi gjendjen ekologjike të lumit, florën, faunën, ndikimiet në mjedis dhe pasojat socio-ekonomike.

*Rezultati 2:*

Zhvillimi i një Plan Menaxhimi të Integruar për burimet ujore dhe biodiversitetin e segmentit lumor Fierzë – Vau Dejës.

**Objektivi 5: Ruajtja e biodiversitetit dhe e shërbimeve që lumi Drin ofron.**

*Rezultati 1:*

Identifikimi i llojeve të kërcënuara dhe të rrezikuara të florës dhe faunës nga ndërhyrjet mbi pellgun e lumit Drin.

*Rezultati 2:*

Hartimi i Planeve të Veprimit një e shumëvjeçare për mbrojtje e llojeve të kërcënuara dhe të rrezikuara.

**Objektivi 6: Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të lumit Drin.**

*Rezultati 1:*

Përshtatja sa të jetë e mundur e programeve dhe e planeve të zhvillimit ekonomik e social me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit të lumit Drin.

**F. Përfituesit nga projekti:**

a. Përfituesit direktë:

**Bizneset e vogla dhe të mesme që veprojnë në fushat e energjisë elektrike, të bujqësisë, të transportit, të peshkimit dhe të turizmit.**

b. *Përfituesit indirektë:*

**Komuniteti vendas dhe njësitë kërkimore e shkencore të institucioneve kërkimore, OJF, Universiteti i Shkodrës dhe Universitetet e tjera.**

c. *Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të lyre?*

**Nepërmjet Raportit Tematik, referimeve në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, publikimeve në revista shkencore dhe një Workshopi.**

**G. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:***

*Plani i përgjithshëm:*

*Plani i punës i detajuar për vitin e parë:*

**VII. Buxheti. Vlerësimi i projektit <u>për vitin e parë</u> në MijëLekë.**

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara)

*A. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do tëkryhet*

| **Personeli i Projektit dhe përqindja e kohës së plotë të Punës që do të angazhohet në Projekt** | | | **Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë** | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emr i | Koha në % | Paga Bazë dhe Shtesat | Gjithsej |
| **1.** | Violeta Alushi | 30% | 950 | **1150** |
| **2.** | Marash Rakaj | 30% | 850 | **950** |
| **3.** | Adem Bekteshi | 25% | 750 | **650** |
| **4.** | Rrok Smajlaj | 25% | 650 | **650** |
| **5.** | Anila Neziri | 25% | 550 | **650** |
| | | **Gjithsej:** | | **4050** |

Totali i pjesshëm (A) në Mijë Lekë: **4050**

*Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë** |
|---|---|---|
| **1.** | Konsulencë juridike | **50** |
| **2.** | Organizimi i një Workshopi | **100** |
| **3.** | Zyra e tatim taksave | **100** |
| **4.** | INSTAT | **50** |
| **5** | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **300**

*Shpenzime Transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhetime në Vau i Dejës – Adem Bekteshi, Marash Rakaj | 100 |
| 2. | Udhetime në Koman – Violeta Alushi, Anila Neziri | 100 |
| 3. | Udhetime në Fierzë - Violeta Alushi, Rrok Smajlaj | 150 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **350**

*Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Violeta Alushi | 100 |
| 2. | Marash Rakaj | 100 |
| 3. | Adem Bekteshi | 100 |
| 4. | Rrok Smajlaj | 100 |
| 5. | Anila Neziri | 100 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **500**

*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*
*C.1.Shpenzime për pajisje specifike*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |

| | | |
|---|---|---|
| **2.** | | |
| **3.** | | |
| **4.** | | |
| **5.** | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*Vlera e plotë e projektit për vitin e parë,* në Mijë Lekë: **5250**

***I. Burimet e Financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në%.***

| **Burimet e Financimit** | **%** | **Në Mijë Lekë** |
|---|---|---|
| **Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese dhe bashkëpuntorët** | 100% | **5200** |
| **Shumaqë do të financohet nga burime të tjera** | | |
| **Shuma që kërkohet të financohet nga PKKZH** | | |
| **Gjithsej** | **100%** | **5200** |

***Në se Projekti zgjat më shumë se një vit, jepet vlerësimi për fondet që kërkohen për çdo vit në MijëLekë :***

| **Viti ifinanc** | **Honorare studimi (zëri 230)** | **Shpenz. Udhët. (zëri 230)** | **Shërb. Të tretët (zëri 230)** | **Shpenz. Transp. (zëri 230)** | **Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230)** | **Totali (zëri 230)** | **Pajisje (zëri 231)** | **Gjithsej** | **Kërk. Nga PKKZH** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1150 | 100 | 50 | 100 | 0 | 1.400 | 0 | 1.400 | |
| 2 | 950 | 100 | 100 | 100 | 0 | 1.250 | 0 | 1.250 | |
| 3 | 650 | 150 | 100 | 100 | 0 | 1.000 | 0 | 1.000 | |
| 4 | 650 | | 50 | 100 | 0 | 800 | 0 | 800 | |
| 5 | 650 | | | 100 | | 750 | | 750 | |
| | | | | | | | **Gjithsej :** | **5.200** | |

***11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese)person juridik?*** **Po**

***12. Kur është I pregatitur institucioni të filloje Projektin?Shtator 2021***

***13. Cilat janë risqet e mundëshme dhe si do të kapërcehen?Zgjatja e pandemisë që do kapërcehet me takimet dhe mbledhjet në platformen on-line.***

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**Prof. as Dr Violeta Alushi**

Firma Data: __.__.____

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof. As. Dr. Ariana Striniqi**

Firma Data: __.__.____

# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## "Luigj Gurakuqi"

### Fakulteti Shkencave te Natyres

## Programi i doktoraturës në "Shkencat Mjedisore"

## DEPARTAMENTI BIOLOGJISË DHE KIMISË

## MODELI- Projekti Kërkimor Shkencor dhe i Zhvillimit

**I. Fusha e Kërkimit Shkencor: "Vlerësimi i ndikimit të HECE-ve mbi florën dhe faunën ujore në pellgun e lumenjve të Cemit dhe të Valbonës"**

**II. Grupi kërkimor-shkencor**: Prof.as.dr. Marash Rakaj (marash.rakaj@unishk.edu.al), Prof.dr. Adem Bekteshi (adem.bekteshi@unishk.edu.al), Prof. dr. Syzana Golemi (syzana.golemi@unishk.edu.al), Prof.as.dr. Rrok Smajlaj (rrok.smajlj@unishk.edu.al ), Prof.as.dr. Violeta Alushi (violeta.alushi @unishk.edu.al), Prof.as.dr. Ariana Striniqi (ariana.striniqi@unishk.edu.al), Universiteti i Shkodrës.

**III. Propozuar si pjesë e Prioriteteve Strategjike të UNISHK me Vendim SA nr. 97 nr. 1026 prot të datës 29.03.2021, ku "Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Ruajtja e Biodiversitetit janë vendosur si dy prej tyre.**

**III. Objektivat e projektit:**

1. Monitorim i rrjedhjes së ujit përgjatë shtretërve të lumenjve.
2. Analizë e parametrave fiziko-kimike ujore përgjatë lumenjve.
3. Vlerësimi i faunës ujore përgjatë lumenjve.
4. Vlerësimi i florës ujore përgjatë lumenjve.
5. Vlerësim i ndikimit të HEC-eve mbi cilësitë kimike të ujërave.
6. Vlerësim i ndikimit të HEC-eve mbi florën dhe faunën ujore, veçanërisht mbi specie e rrallë dhe të rrzikuar.
7. Propozimi i rrugëve inovative të zhvillimit ekonomik e social në luginat e lumenjve malore, duke ruajtur natyrën dhe biodiversitetin.

## IV. Personeli i Projektit:

| Emri Mbiemri | Titulli shkencor | Posti që mban | IAL |
|---|---|---|---|
| Drejtuesi i Grupit Kérkimor | | | |
| Marash Rakaj | Prof.as.dr. | Lektor | UNISHK |
| Bashkëpunëtorë shkencore | | | |
| Adem Bekteshi | Prof.dr. | Lektor | UNISHK |
| Suzana Golemi | Prof.dr. | Lektor | UNISHK |
| Rrok Smajlaj | Prof.as.dr. | Lektore | UNISHK |
| Anila Neziri | Prof.dr | Lektore | UNISHK |
| Violeta Alushi | Prof.as.dr. | Lektore | UNISHK |
| Ariana Striniqi | Prof.as.dr. | Lektore | UNISHK |

## V. Argumentimi shkencor i Projektit.

***A. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*** **Synimi i këtij Projekti kërkimor-shkencor është vlerësimi i ndikimit të HEC-ve mbi cilësitë kimike dhe mbi biodiversitetin e burimeve ujore të dy lumenjve, si dhe dhënja e alternativave të tjera të zhvillimit ekonomik e social që nuk dëmtojnë mjedisin dhe biodiversitetin.**

Larmia biologiike dhe pejsazhi alpin i lumenjve malorë përbëjnë një pasuri natyrore shumë të çmuar, e cila duhet të përdoret në menyrë të qëndrueshme duke e ruajtur dhe zhvilluar më tej.
Habitatet e lumenjve strehojnë një florë dhe faunë ujore të larmishme, endemike dhe të rrezikuar.
Shumica e këtyre Habitateve dhe popullatat e specieve të rralla dhe të rrezikuara janë renditur në ligjet dhe konventat kombëtare e ndërkombëtare, si **Direktiva e Habitateve** (*Directive 92/43/EEC*), **Natura 200, CITES** etj., duke e rritur më tej rëndësinë e këtyre mjediseve natyrore në shkallë ndërkombëtare.
Studimet e deritanishme për ndikimin e hidrocentraleve (HEC-ve) mbi cilësitë kimike dhe mbi biodiversitetin në ekosistemet ujore kanë qenë të kufizuara. Studime më intensive ndër dhe disiplinore do të ishin me shumë rëndësi për vlerësimin e thelluar të ndikimeve të mundshme të shkaktuara nga hidrocentralet.
Studime të tilla synojnë vlerësimin e statusit aktual të florës dhe faunë ujore dhe zhvillimet e ardhshme nën stresin e mundshëm mjedisor të HEC-ve.
Lumi Valbonës dhe i Cemit, ashtu si edhe lumi i Shalës, Nikaj-Merturit, Gashit etj. shtrihen në relieve kryesisht alpine e malore brënda Alpeve të Shqipërisë ku shquhen për një diversitet të lartë gjeomorfologjik dhe biologjik.
Lumi i Cemit, me gjatësi 26 km brënda territorit të Shqipërisë, shtrihet përgjatë dy luginave të Kelmendit (Selcës dhe Vukë-Nikcit), dhe pasi del në Malin e Zi, i bashkohet Lumit Moraça për tu derdhur në Liqenin e Shkodrës.
Të dy luginat, së bashku me Vermoshin janë zona të mbrojtura dhe janë propozuar të shpallen Park Kombëtar, brënda Parkut Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë.
Lumi i Valbonës, me gjatësi 50.6 km, buron në Valbonë dhe pasi përshkon luginën e Tropojës derdhet në Lumin Drin, në Fierzë. Lugina e Valbonës me sipërfaqe 8000ha gëzon statusin Park Kmbëtar qysh prej vitit 1996.
Dekadën e fundit janë parashikuar e miratuar ndërtimi i shumë HEC-eve përgjatë lumenve malore, bile edhe brënda zonave të mbrojtura, si përgjatë lumit të Valbonës, lumit të Cemit, Lumit të Nikaj-Merturit etj.

Studime të ndryshme kanë treguar se HEC-et degradojnë gradualisht vlerat ekologjike të lumenjve, si dhe bie ndesh qartësisht me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht në Zonat e Mbrojtura.
Nërtimi i HEC-ve përgjatë lumenjve, shpesh ka krijuar edhe problem ekonomike e sociale tek banorët vendas pë arsye të mungesës së ujit për vaditje e ndonjë rast edhe të ujit të pishëm.
Shumica e vendeve europiane kanë braktisur prodhimin e hidroenergjisë mga lumenjtë duke përdorur rrugë t tjera, bile edhe më efikase dhe pa pasoja për mjedisin.
Prandaj kërkohet një përgjegiësi dhe ndërgjegjësim më i lartë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm t vlerave natyrore dhe të biodiversitetit të ekosistemeve ujore, veçanërisht të ekosistemeve të ujërave të ëmbla.
Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave natyrore dhe biologjike të ekosistemeve dhe habitateve lumore do të nxiste zhvillimin e një ekoturizmi të qëndrueshëm, i cili do zhvillonte bizneset lokale dhe do gjeneronte të ardhurat për komunitetin vendas.

## B. Punime të kryera deri tani ose që janë në progres në ketë fushë

A. PAPARISTO, B. PEPA & M. RAKAJ. 2017: "Enabling Transboundary Cooperation and Integrated Wate Resources Management in the Extended Drin River Basin", GEF Project "

A. BEKTESHI & I. LEKA. 2001: "Dynamics of changing of chemical of Shkodra lake water" Journal o Environmental Protection and Ecolog Vol. 2, Nr.3, pp. 632-636.

L. KASHTA, M. RAKAJ & V. ZENELI. 2016: The diversity of aquatic macrophytes in the transboundary lakes of Shkodra, Ohrid and Prespa – Albanian. Buletini Matematika dhe Shkencat e Natyres Nr.20: 28-39 Botim i Universitetit te Tiranes, Fakulteti i Shkencave te Natyrës.

M. BARBIERI. A GARONE, A. NEZIRI. M. ROSSI: 2015: First groundwater chemical status assessment o the Buna River. Protected Landscape (Albania). Environmental Earth Sciences (Impakt faktor Thomson Scientific IF 2014 1.765). 2015

M. RAKAJ. 2012: Biological Conditions of the Lake Shkodra and Buna River. Journal of Environmental Protection and Ecology 13(3): 1397-1404. SciBultCom Ltd. ISSN: 1311$065. Impact Factor (Thomson Scientific 2011).

M. RAKAJ. 2012: Consideration on the eutrophication in the Lake of Shkodra. *International Conference on Toward Future Sustainable Development*, Shkoder, Al. 16-17 November, p.35-39. ISBN: 978-9928-4011-9-9.

M. RAKAJ & DH. DHORA. 2012: Conspicuous Values and Incisive Environmental Problems of Buna River. Journal of Environmental Protection and Ecology 13(3): 1366-1374. SciBullCom Ltd. ISSN: 1311-5065. Impact Factor (Thomson Scientific 2011) = 0.102. http://eee.iepe-iournal.infO/joumal•content/vol-13-n03-2012.

M. RAKAJ & L. KASHTA. 2017: The diversity and protected status of aquatic tracheophytes in the transboundary lakes of Shkodra, Ohrid and Prespa – Albanian part. Buletini Shkencor, Seria e Shkencave të Natyrës, nr.67: 67-83.

M. RAKAJ & RR. SMAJLAJ. 2010: Vlerësim paraprak i Statusit Ekologjik të Lumit Buna. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 60:145-154.

M. RAKAJ. & RR. SAMAJLAJ. 2015. Kontribut mbi implementmin e Direktivës së Habitateve për mjediset ujore të Shqipërisë. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 65: 103-116. ISSN 2221-6847.

M. RAKAJ, V. ALUSHI & RR. SMAJLAJ. 2020: Specie aliene të ujërave të ëmbla të Shqipërisë. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave të Natyrës, nr. 22 (*në botim*).

N. FRASHËRI, M. RAKAJ, F. MANDIJA & J. BUSHATI. 2021: Observation of Shkodra Lake water quality using satellite imagery.*1st International Conference on Water Environmental Protection and Sustainable Development WEPSD*, 17-18 Maj 2021, Tiranë, Albania.

V. ALUSHI & M. RAKAJ. 2011: Overview of Protists of the Shkodra Lake. *International Journal o Ecosystems and Eclogy Sciences (IJEES)*, vol 1. "Special issue, ICE 2011", p. 1-6. ISBN: 2224-4980.

**C. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombetare të Kërkimit e Zhvillimit):**

ANONIMA: 2020 -2021: Vlerësimi i cilësisë ekologjike të ujit të ekosistemit ujor të Liqenit të Shkodrës sipa standardeve të BE dhe të Direktivës Kuadër të Ujërave (DKU). Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit t Shkodrës dhe Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë. Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Shkodrë "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

L. KASHTA & M. RAKAJ. 2018: Vlerësimi i gjendjes ekologjike të liqeneve Ohër,Prespë dhe Shkodë mbështetur në Indeksin e makrofiteve. Buletini Shkencor i USH "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave t Natyrës, nr. 61.

D. ***Objektivi i zhvillimit:*** **Vlerësimi i ndikimit të hidrocentraleve mbi cilësitë kimike dhe mbi biodiversitetin e ekositemeve lumore dhe propozimi i alternativave të tjera të zhvillimit ekonomik pa dëmtuar mjedisin dhe biodiversitetin.**

E. ***Objektivat imediate dhe rezultatet e pritëshme:***

**Objektivi 1: Monitorim i rrjedhjes së ujit përgjatë lumenjve.**

*Rezultati 1:*

Identifikimi i sasië së ujit që rrjedh përgjatë lumenjve, mbi dhe poshtë HEC-ve.

*Rezultati 2:*

Gjendja e habitateve ujore përgjatë lumenjve, veçanërisht poshtë HEC-ve..

**Objektivi 2: Analizë e parametrave fiziko-kimike ujore përgjatë dy lumenjve**

*Rezultati 1:*

Gjendja e cilësive fiziko-kimike të ujërave përgjatë lumit.

*Rezultati 2:*

Niveli i ndotjes kimike dhe bakteriologjike të ujërave përgjatë lumit.

**Objektivi 3: Vlerësimi i faunës ujore përgjatë dy lumenjve (mbi dhe nën HEC-e).**

*Rezultati 1:*

Gjendja e popullatave të specieve të ndryshme të kafshëve ujore (peshq etj.) përgjatë lumenjve.

*Rezultati 2:*

Gjendja e popullatave të specieve të rralla dhe të rrezikuara të kafshëve ujore përgjatë lumenjve.

**Objektivi 4: Vlerësimi i florës ujore përgjatë dy lumenjve (mbi dhe nën HEC-e).**

*Rezultati 1:*

*Rezultati 2:*

Gjendja e popullatave të specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve ujore (makrofiteve) përgjatë lumenjve.

**Objektivi 5: Vlerësim i ndikimit të HEC-eve mbi cilësitë kimike të ujërave.**

*Rezultati 1:*

Hartimi i një baze të dhënash mbi vlerat e parametrave fiziko-kimike ujore mbi dhe poshtë HEC-eve

*Rezultati 2:*

Gjendja e nivelit të ndotjes kimike dhe bakteriologjike të ujërave përreth HEC-eve.

**Objektivi 6: Harimi i një Raporti mbi vlerësim i ndikimit të HEC-ve mbi florën dhe faunën ujore, veçanërisht për speciet e rralla dhe të rrezikuara.**

*Rezultati 1:*

Një bazë të dhënash mbi gjendjen e popullatave të specieve të bimëve dhe kafshëve ujore përgjatë lumenjëve.

*Rezultati 2:*

Raporti mbi gjendje e popullatave të specieve të bimëve dhe kafshëve ujore të rralla dhe të rrezikuara përgjatë lumenjëve.

**Objektivi 7: Propozim i rrugëve inovative të zhvillimit ekonomik në luginat e lumenjve malore, duke ruajtur natyrën dhe biodiversitetin.**

*Rezultati 1:*

Hartimi i një strategjie të zhvillimit ekonomik të luginave të lumenjve malore duke ruajtur naturen dhe biodiversitetin në përshtatje me ligjet, direktivat dhe konventat kombëtare e ndërkombëtare.

*Rezultati 2:*

Hartimi i një Programi e Plan veprimi për zhvillimin ekoturistik të luginave të lumenjve malore, si rruga më e përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm sipas objektivave të Axhendës 230.

***F. Përfituesit nga projekti:***

a. *Përfituesit direktë:*

**Bizneset e vogla dhe të mesme të fermave bujqësore e blegtorale dhe bizneset e vogla të transportit dhe turizmit malor.**

b. *Përfituesit indirektë:*

**Komuniteti vendas, njësitë administrative vendore, OJF-të dhe njësitë kërkimore dhe shkencore të Universitetit të Shkodrës dhe të universiteteve të tjera.**

c. *Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të lyre?*

**Nepërmjet raportit përfundimtar, referimeve në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, publikimeve në revista shkencore dhe organizimit të një workshopi.**

g. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vilin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

***Plani i përgjithshëm i punës:***

***Plani i punës i detajuar për vitin e parë:***

## VI. Buxheti. Vlerësimi i projektit për vitin e parë në Mijë Leké.

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara)

*A. Honorare për përgatitjen e projektit dhe për studimin që do të kryhet.*

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës të plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri** | **Koha në %** | **Paga bazë dhe shtesat** | **Gjithsejt** |
| 1. | Marash Rakaj | 40% | 1050 | 1250 |
| 2. | Adem Bekteshi | 35% | 950 | 1050 |
| 3. | Suzana Golemi | 25% | 750 | 750 |
| 4 | Rrok Smajlaj | 30% | 650 | 750 |
| 5. | Anila Neziri | 25% | 550 | 650 |
| 6. | Violeta Alushi | 25% | 550 | 650 |
| 7. | Ariana Striniqi | 25% | 550 | 650 |
| | | **Gjithsej:** | | **5750** |

Totali i pjesëshëm në Mijë Lekë: **5750**

*Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit.*

| Nr. | **Emërtimi** | **Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë** |
|---|---|---|
| 1. | Konsulencë juridike | 100 |
| 2. | Organizimi i një Workshopi | 150 |
| 3. | Të dhëna ekonomike nga bizneset | 150 |
| 4. | Zyra tatimtaksave | 100 |
| 5. | INSTAT | 100 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **600**

*Shpenzime Transporti (për nevojat e studimit të fisibilitetit*

| Nr. | **Emërtimi** | **Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë** |
|---|---|---|
| 1. | Udhëtime në Tamarë – Adem Bekteshi, Violeta Aushi | 100 |
| 2. | Udhëtime në Lëpushë – Suzana Golemi, Rrok Smajlaj | 100 |
| 3. | Udhëtime në Vukël – Anila Neziri, Marash Rakaj, Ariana Striniqi | 150 |
| 4. | Udhëtime në Valbonë – Marash Rakaj, Rrok Smajlaj, Violeta Alushi | 150 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **500**

*Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Marash Rakaj | 100 |
| 2. | Adem Bekteshi | 100 |
| 3. | Suzana Golemi | 100 |
| 4. | Rrok Smajlaj | 100 |
| 5. | Ariana Striniqi | 100 |
| 6. | Violeta Alushi | 100 |
| 7. | Anila Neziri | 100 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë: **700**

*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fisibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

C. *Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme të trupëzuara*

*CI. Shpenzime për pajisje specifike*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*Vlera e plotë e projektit për vitin e parë, në Mijë Lekë*: 7550

*I. Burimet e Financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në%.*

| Nr. | Burimet e Financimit | % | në Mijë Lekë |
|---|---|---|---|
| 1. | Shuma që do të financohet nga vet Agjensia Ekzekutuese dhe Bashkpunëtorët | 100% | 7550 |
| 2. | Shuma që do të financohet nga burime të tjera | | |
| 3. | Shuma që këkohet të financohet nga PKZH | | |
| | Gjithsej: | 100 % | 7550 |

*Nëse Projekti zgjat më shumë se një vit do të jepet vlerësimi për fondet që kërkohen për çdo vit në Mijë Lekë:*

| Viti ifina nc | Honorar e studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. Të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej | Kërk. Nga PKK ZH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 1250 | 100 | 100 | 100 | | | | 1.550 | |
| 2. | 1050 | 100 | 150 | 100 | | | | 1.400 | |
| 3. | 750 | 100 | 150 | 150 | | | | 1.150 | |
| 4. | 750 | 100 | 100 | 150 | | | | 1.100 | |
| 5. | 650 | 100 | 100 | | | | | 850 | |
| 6. | 650 | 100 | | | | | | 750 | |
| 7. | 650 | 100 | | | | | | 750 | |
| | | | | | | | Gjithsej: | 7.750 | |

11. *A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese) person juridik?* *Po*

12. *Kur është i pregatitur institucioni të filloje Projektin?* *Tetor 2021*

13. *Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen? - Zgjatja e pandemisë, e cila do të kapërcehet me takime dhe mbledhje në platformën on-line.*

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**Prof. As. Dr. Marash Rakaj**

Firma Data: __.__.____

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof. As. Dr. Ariana Striniqi**

Firma Data: __.__.____

# Fakulteti i Shkencave te Natyres

# Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

## Programi i doktoraturës "Shkenca mjedisore"

## DEPARTAMENTI I BIOLIGJI-KIMISE

## MODELI- Projekti Kërkimor Shkencor dhe i Zhvillimit

**I. Fusha e Kërkimit Shkencor: Ekotoksikologji dhe aspekte te kimise e biokimise mjedisore**

**II.** **Grupikërkimor-shkencor:** Prof.Dr.AnilaNeziri (anila.neziri@unishk.edu.al),
**III.** Prof.dr.Suzana Golemi (suzana.golemi@unishk.edu.al ),

**IV. Objektivat e projektit:**

1. Studimi i ndotjes se mjedisit dhe pasojave te saj ne boten e gjalle .
2. Monitorim i parametrave fiziko kimike te ujit, ajrit, tokes dhe biotes.
3. Monitorimi i ndryshimeve biokimike ne biote si rezultat i ndotjes kimike.
4. Monitorim i lendeve toksike ne mjedis (ndotes organike).
5. Studimi i efekteve toksike qe shkakton ndotja ne boten e gjalle.

7. Studimi i efekteve negative qe sjell ndotja e mjedisit ne biodiversitet dhe turizem.

**V.PersoneliiProjektit:**

| **EmriMbiemri** | **Titullishkencor** | **Postiqëmban** | **IAL** |
|---|---|---|---|
| *DrejtuesiiGrupitkërkimor* | | | |
| AnilaNeziri | Prof.dr. | Lektore | UNISHK |
| *Bashkëpunëtorëtshkencore* | | | |
| Suzana Golemi | Prof..dr. | Lektore | UNISHK |
| Neira Medja | Prof.as.Dr | Lektore | UNISHK |

***VI.* Argumentimi shkencor i Projektit.**

*A. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes sëtij:* **Nëpërmjet këtij projekti kërkimor-shkencor do të synohet të monitorohet ndotja e mjedisit nga kimikatet dh e aktiviteti njerezor dhe efektet qe ajo shkakton ne boten e gjalle nepermjet studimeve te integruara kimke, toksikologjike dhe biokimike.**

Rritja industriale gjatë një periudhe prej gati pesë dekadash nuk u shoqërua me masa adekuate teknike për parandalimin e ndotjes. Ujërat e ndotura nga nga qyteti i Shkodrës përfundojnë në liqenin e Shkodres dhe lumin Buna me trajtim minimal ose aspak.. Situata aktuale, me aktivitete njerëzore duke përfshirë peshkimin dhe turizmin ilegal, si dhe gjuetinë pa leje, varka, ndërtimet pa leje, bujqësinë, rrjedhjet urbane dhe mungesën e trajtimit të ujërave të ndotura të ndotura nga PCB dhe metalet e rënda (balta e kuqe e hedhur nga alumini i KAP impianti), rrezikojnë stabilitetin e ekosistemit të Liqenit të Shkodrest. **[Kantic, A 2007 ]** .Një numër OCP dhe PCB janë zbuluar tashmë në ujërat dhe degët e Liqenit të Shkodrës / Skadar duke përdorur metodat konvencionale të marrjes së mostrave dhe nxjerrjes (**Misurovic A., 2002**).

Ndërsa ekonomia shqiptare vazhdon të rritet përdorimi në rritje i plehrave artificialë dhe pesticideve nga punëtorët e paedukuar të bujqësisë , pritet gjithashtu të ketë efekte të dëmshme si në cilësinë e ujit ashtu edhe në ekosistemin e gjerë (UNECE, 2002)

Janë identifikuar kërcënimet 'e mëposhtme për ndotjen e tokës, ujit dhe cilësisë së sedimenteve dhe biodiversitetit të ekositemeve ujore :

- Ndotja (industri, mbetje të ngurta, mbetje të lëngëta);

Për të vlerësuar rrezikun e efekteve që lidhen me numrin e madh të substancave që janë të pranishme dhe zbulohen në mjedis (përfshirë ndotësit në zhvillim, metabolitët dhe produktet e transformimit)

Analiza kimike është një hap themelor në vlerësimin e statusit të ujit sipërfaqësor nën WFD. Analiza kimike në përgjithësi kërkon njohuri apriori në lidhje me llojin e substancave që do të monitorohen ndërsa, për arsye teknike dhe ekonomike, nuk është e mundur të analizohen, zbulohen dhe përcaktohet sasia e të gjitha substancave që janë të pranishme në mjedisin ujor. Ekziston një nevojë për të kuptuar se cilat janë efektet reale të shkaktuara nga prania e substancave kimike në mjedisin ujor (përfshirë ndotësit në zhvillim, metabolitët dhe produktet e transformimit) dhe për të lidhur efektet e vëzhguara me objektivat e menaxhimit me kosto efektive. Ky është thelbi i propozimit të Projektit. Mjetet bio analitike japin një vlerësim më holistik të kimikateve biologjikisht aktive të pranishme në ujë, sepse ato janë në gjendje të zbulojnë toksicitetin e përzierjes dhe efektet e metabolitëve dhe të panjohurave. Pak a shumë çdo lloj shembulli mund të analizohet, dhe rezultatet shpesh shprehen në bazë ekuivalente kimike. Disa nga mjetet mund të përdoren gjithashtu për një vlerësim të hershëm të rreziqeve të mundshme për shëndetin e njeriut (p.sh. prova mutagjenetike), në lidhje me konsumin e produkteve të peshkut ose ujit të pijshëm. Për më tepër, ato mund të integrojnë dhe vlerësojnë mënyrat antagoniste të veprimit që potencialisht mund të jenë të pranishme në mostër. Për shkak të kostove relativisht të ulëta dhe aftësisë për të zbuluar një numër të madh të substancave që kanë të njëjtën mënyrë veprimi, disa bioteste in vitro janë të përshtatshme për qëllime të studimi paraprak.. Mjetet bio-analitike të aplikuara për vlerësimin e cilësisë së ujit do të vendosin se cila përgjigje e bio-vlerësimit konsiderohet të tregojë një rrezik mjedisor.

Analizat kimike përdoren zakonisht në programet e monitorimit të cilësisë së ujit dhe ofrojne informacion të rëndësishëm në lidhje me përqendrimin e kimikateve, por shpesh është e pamjaftueshme për të reflektuar numrin e madh të kimikateve të ndryshëm të pranishëm në një mostër. Qasja e kombinuar kimike dhe toksikologjike ka potencialin për një vlerësim gjithëpërfshirës të cilësisë së ujit dhe është propozuar që të plotësohet vlerësimi i statusit kimik me metoda të bazuara në efekt.

*B. Punime të kryera deri tani ose që janë në proçes në këtë fushë në institucione të tjera*

✓A. NEZIRI, E. MARKU, I. MALOLLARI: Organochlorine Pesticides Concentrations in Surface Waters of Lakes of Shkodra, Oh rid and Prespa (Albanian Part) JEPE, Vol. 17. No. 3,2016
✓M. BARBIERI, A. GARONE, A. NEZIRI, M. ROSSI: First groundwater chemical status assessment of the Buna River- Protected Landscape (Albania). *Environmental Earth Sciences* (Impakt faktor Thomson Scientific IF 2014 1.765), 2015
✓A. Neziri, I. Malollari , E.Laho, A. Pambuku : Persistent Organic Pollutants in the Buna River Basin Ground (Albania) , Journal of Environmental Protection and Ecology , **Vol. 15, No 2: 2014.** http://www.jepe.gr/

S. Golemi , N. Medja, Hematological and biochemical indices of the eel (Anguilla anguilla l., 1758) collected from the shkodra lake, albaniaJanuary 2014Journal of Environmental Protection and Ecology 15(1):204-209
S. Golemi , N. Medja, D.Lacej A COMPARATIVE STUDY ON BLOOD PARAMETERS OF TWO CYPRINID FISHES LIVING IN THE SHKODRA LAKE (ALBANIA) 2013Journal of Environmental Protection and Ecology 14(3):939-946

C. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

D. *Objektivi izhvillimit:–* **Monitorimi i ndotjes se mjedisit nga kimikatet dhe aktiviteti njerezor dhe efektet qe ajo shkakton ne boten e gjalle nepermjet studimeve te integruara kimke, toksikologjike dhe biokimike.**

E. *Objektivatimediatedherezultatet e pritëshme:*

*Objektivi 1:*

**Studimi i ndotjes se mjedisit dhe pasojave te saj ne boten e gjalle .**

*Rezultati 1:*
**Krijimii një baze te dhenash ne lidhje me ndotjen e mjedisit dhe pasojat ne boten e gjalle**

*Rezultati 2*
**Krahasimi i te dhenave te marra me studime te ngjashme dhe normat e EU**

*Objektivi 2:*

Monitorim i parametrave fiziko kimike te ujit, ajrit.

*Rezultati 1:*
**Percaktimi i gjendjes trofike te ujerave natyrore .**

*Rezultati 2:*

*Percaktimi i nivelit te ndotjes*

*se ajrit mjedisor*

*Objektivi 3:*

Monitorimi i ndryshimeve biokimike ne biote si rezultat i ndotjes kimike.

*Rezultati 1:*
**Percaktim i i llojeve te rrezikuara nga ekspozimi kimik dhe efekteve te toksikanteve tek biota. .**

**Objektivi 4:** . Monitorim i lendeve toksike ne mjedis (ndotes organike).

*Rezultati 1:*

**Identifikimi dhe kuantifikimi i lendeve toksike organike qe mund te jene prezente ne ekositemet ujore natyrore bazuar ne Direktiven Kuader te Ujit (WFD)**

**Objektivi 5:** Studimi i efekteve toksike qe shkakton ndotja ne boten e gjalle..

Rezultati 1: Aplikimi i i biotesteve in vitro per pte percaktuar efektin e toksikanteve ne biote

Rezultati 1: Aplikimi i metodave bioanalitike per percaktimin e efektit te toksik te kimikateve ne bioten ujore

*F. Përfituesitngaprojekti:*

*a. Përfituesitdirektë:*
*Studente dhe studjues te fushave perkatese, intitucionet*

*b. Përfituesit indirektë:*
*Komuniteti i Rajonit te Shkodres i cili informohet per gjenjen ekologjike te ekosistemeve ujore qe gjenden ne te*

*c. Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*
**Nëpërmjet publikimeve shkencore ne lidhje me rezultatet e arritura**

*G. Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet tëpërdoren:*

*Plani ipërgjithshëm:*

*Plani i punës I detajuarper vitin e parë:*

**VII. Buxheti. Vlerësimi i projektit <u>për vitin e parë</u> në MijëLekë.**

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara)

*A. <u>Honorarepërpërgatitjeprojektidhepërstudiminqë</u> do tëkryhet*

| Personeli i Projektit dhe përqindja e kohës së plotëtë Punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | PagaBazëdhe Shtesat | Gjithsej |
| 1. | AnilaNeziri | 30% | 1700 | 1600 |
| 2. | Suzana Golemi | 30% | 1500 | 1400 |
| 3. | Neira Medja | 25% | 1200 | 1100 |
| | | Gjithsej: | | 4 100 |

Totali i pjesshëm (A) në Mijë Lekë :

*Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit tëfizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Konsulencejuridike | 50 |
| 2. | Te dhena ekonomike nga bizneset turistike | 100 |
| 3. | Zyra e tatimtaksave | 100 |
| 4. | INSTAT | 50 |
| 5 | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*ShpenzimeTransporti (përnevojat e studimittëfizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhetimi ne Velipojë – Anila Neziri | 50 |
| 2. | Udhetim ne Vau i Dejes – Suzana Golemi | 50 |
| 3. | Udhetim ne Malesi te Madhe – Neira Medja | 50 |
| 4. | | 5 |
| 5. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit tëfizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | AnilaNeziri | 50 |
| 2. | Suzana Golemi | 50 |
| 3. | Neira Medja | 50 |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit tëfizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Anila Neziri | 30 |
| 2. | Suzana Golemi | 30 |
| 3. | Neira Medja | 30 |
| 4. | | |
| 5. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit tëfizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | Kampionim ne terren Anila Neziri | 50 |
| 2. | Kampionim ne terren Suzana Golemi | 50 |
| 3. | Kampionim ne terren Neira Medja | 50 |
| 4. | | |
| 5. | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*
*C.1.Shpenzime përpajisjespecifike*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë |
|---|---|---|
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |
| 4. | | |
| 5. | | |
| 6. | | |
| 7. | | |
| 8. | | |
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë:

*Vlera e plotë e projektit për vitin e parë*, në Mijë Lekë :

I. **Burimet e Financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në%.**

| Burimet e Financimit | % | nëMijë Lekë |
|---|---|---|
| Shumaqë do tëfinancohetngavetëAgjenciaEkzekutuesedhe bashkëpuntorët | 100% | 6800 |
| Shumaqë do tëfinancohetngaburimetëtjera | | |
| ShumaqëkërkohettëfinancohetngaPKKZH | | |
| Gjithsej | 100 % | 6800 |

*NëseProjektizgjatmëshumë se një vit, jepetvlerësimipërfondetqëkërkohenpërçdovit*

***nëMijëLekë*** :

| Vitiifinanc | Honorarestudimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. tëtretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej | Kërk. Nga PKKZH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1600 | 50 | 50 | 50 | 50 | 1800 | 100 | 2800 | |
| 2 | 1400 | 50 | 100 | 50 | 50 | 1 650 | 500 | 2150 | |
| 3 | 1100 | 50 | 100 | 50 | 50 | 1.350 | 500 | 1.850 | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | Gjithsej : | 6.800 | |

**11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese)personjuridik?** Po

**12. Kur ështëipregatiturinstitucionitë fillojë Projektin?Shtator 2021**

**13. Cilatjanërisqet e mundëshmedhesi do të kapërcehen?Zgjatja e pandemisëqë do kapërcehet me takimetdhembledhjet on-line**

**Drejtuesi iGrupit Kërkimor**

**Prof. Dr. Anila Neziri**

Firma Data: __.__.____

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof. As. Dr. Arjana Striniqi**

Firma Data: __.__.____

Nr: 1947 prot
dt: 18.06.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "*Luigj Gurakuqi*"

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

**DEKANI**

*Nr. 460 prot.* *Shkodër, më 18.6. 2021*

***Lënda:*** ***Kërkesë për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit për programin e studimeve doktorale në "Gjuhë shqipe"***

**Drejtuar:** **Prof. dr. Suzana GOLEMI**
**Rektore e Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*"**
**Senatit Akademik tëUniversitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*"**
**Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe të Statutit të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", të rregullores së Fakulteti të Shkencave Shoqërore të USH dhe në mbështetje të VKM nr.185, datë 25.03.2021, "*Mbi disa ndryshime dhe shtesa tnë VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programve të studimit të ofruara nga IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", të ndryshuar, përcjellim për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", projektin e madh kërkimor shkencor për programin e studimeve doktorale në "Gjuhë shqipe", titulluar "***Gjuha e shkruar e autorëve të trevës së Veriut***", bashkëshoqëruar edhe me projektet e nënprojektet konkrete.

Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni:

- Vendimin e Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe të Departamentit të Gjuhësisë.
- Përmbledhësen e projekteve kërkimore – shkencore
- Projektet përkatëse.

**DEKANI**

**Prof. dr. Artan HAXHI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I SHKODRËS "*Luigj Gurakuqi*"**
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

*Shkodër, më 18. 6. 2021*

**VENDIM**

**Nr ____, datë 18. 6. 2021**

**"MBI MIRATIMIN E DRAFT- PROJEKTEVE KËRKIMORE DHE TË ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATURËS NË "GJUHË SHQIPE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe të Statutit të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", të rregullores së Fakulteti të Shkencave Shoqërore të USH dhe në mbështetje të VKM nr.185, datë 25.03.2021 "*Mbi disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programve të studimit të ofruara nga IAL*", të ndryshuar, Udhëzimit të MASR nr. 7, datë 31.03.2021 "*Mbi disa ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", i ndryshuar, asambleja e Qendrës së Studimeve Alabanologjike dhe e Departamentit të Gjuhësisë, në mbledhjen e datës 18. 6. 2021, shqyrtoi dhe unanimisht

vendosi:

1. Miratimin e draft - projekteve kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit të programit të studimit të doktoraturës në "*Gjuhë shqipe*" , si më poshtë :
   a. "Gramatikat e shqipes shek. XVIII-XIX"
      - *Kontribute me vlerë në fushë të albanologjisë (Gramatika e dijetarit frances August Dozon "Manuel de la langue chkipe ou albanaise" – 1879);*
   b. "Ndihmesa të autorëve shqiptarë në mërgim për zhvillimin e gjuhës shqipe në rrafshe të ndryshme gjuhësore" :
      - *Fjalësi i veprave të Arshi Pipës;*
   c. "Leksiku i veprave të Ndre Mjedës dhe rimari (K. Ashta)";
   d. "Dom Ndoc Nikaj - Rilindasi i fundit";
   e. "Leksiku në veprën e atë Gjergj Fishtës ("Lahuta e malcis", "Mojs Golemi")".
2. Ky vendim i përcillet dekanit për procedura të mëtejshme.

| Drejtori i QSA | Përgjesësi i departamentit |
|---|---|
| Dr. Zamira SHKRELI | Prof. as. dr. Orjeta BAJA |

PROJEKT

# GJUHA E SHKRUAR E AUTORËVE TË TREVËS SË VERIUT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "*LUIGJ GURAKUQI*"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

**Programi i doktoraturës "Gjuhë shqipe"**

**PROJEKTI :**

**"GJUHA E SHKRUAR E AUTORËVE TË TREVËS SË VERIUT"**

Ky është një projekt i madh, në bazë të të cilit ka punuar Qendra e Studimeve Albanologjike për vite me radhë. Ai ka për qëllim të evidentojë e të studiojë kontributin gjuhësor të disa shkrimtarëve të trevës së Veriut, për të cilët mungojnë plotësisht ose pjesërisht hulumtimet, mbasi një pjesë e tyre kanë qenë të ndaluar ose të harruar në të kaluarën.

Ky projekt do të përbëhet nga projekte më të vogla, të cilat do të ndërmarrin studimin e hulumtimin e gjuhës së autorëve të veçantë, të kontributeve të tyre në lëmë të gjuhësisë apo edhe të ngjarjeve kryesore gjuhësore.

**Plani afatgjatë i punës 2021 - 2031**

Ky është një projekt afatgjatë (10 vjeçar), në bazën e të cilit është organizuar e do të organizohet puna kërkimore shkencore e Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe të departamentit të Gjuhësisë. Në këtë bazë do të orientohet edhe puna e ciklit të tretë të studimeve dhe e ciklit të dytë (Master shkencor).

*Ai do të përqendrohet në këto drejtime :*

1. Analizë e gjuhës së veprave të autorëve të trevës së Veriut.
2. Kontributi i gjuhëtarëve vendës e të huaj në fushë të studimeve gjuhësore.
3. Vlerësimi i tubimeve shkencore me karakter gjuhësor.
4. Gjurmimi dhe studimi i pasurisë gjuhësore të trevës së Veriut të pasqyruara në botimet e ndryshme letrare, gjuhësore ose të mbledhura në ekspedita të veçanta.
5. Organizimi i sesioneve shkencore
6. Realizimi i doktoraturave dhe i botimeve etj..

*Ky studim do të kryhet nga:*

- Anëtarë të Qendrës Shkencore të Albanologjisë (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Pedagogë të departamentit të Gjuhësisë;
- Studentë të doktoraturës ose të Masterit shkencor

*Tematikat :*

*Studim i gjuhës së autorëve të traditës:*

1. Preng Doçi (1846 – 1917),
2. Filip Shiroka (1859 – 1935),

3. Anton Xanoni (1863 – 1911),
4. Ndoc Nikaj (1864 – 1945),
5. Ndre Mjeda (1866 – 1937),
6. Gjergj Fishta (1871 – 1940),
7. Mati Logoreci (1867 – 1941),
8. Bernardin Palaj (1894 – 1947),
9. Shtjefën Gjeçovi (1874 – 1927),
10. Luigj Gurakuqi (1879 – 1925),
11. Hilë Mosi (1885 – 1933),
12. Vinçenc Prendushi (1885 - 1949),
13. Anton Harapi (1888 - 1940),
14. Donat Kurti (1903 - 1983),
15. Lazer Shantoja (1892 – 1945),
16. Justin Rrota (1889 – 1964),
17. Karl Gurakuqi (1895 – 1965),
18. Ethem Haxhiademi (1902 - 1965),
19. Ernest Koliqi (1903 - 1975),
20. Migjeni (1911 – 1937),
21. Risto Siliqi (1882 - 1936),
22. Gaspër Pali (1916 - 1942),
23. Qemal Draçini (1922 - 1947),
24. Haki Stermilli (1895 - 1953),
25. Martin Camaj (1925 - 1992),
26. Arshi Pipaj (1920 - 1997),
27. Injac Zamputi, (1910 - 1998),
28. Azem Shkreli (1938 - 1997) etj..

Evidentimi, dhe riprodhimi i gramatikave për shqipen të hartuara në shek. XVIII-XIX, si gramatika e :

1. *F. M. Da Lecces (1716),*
2. *E. M. Likut (1814),*
3. *Sh. Shkodrës (1850),*
4. *J. De Radës (1894),*
5. *O. Dozonit (1879),*
6. *G. Majerit,*
7. *H. Pedersenit (1895),*
8. *F. Rosit (1866),*
9. *G. Jungut (1880),*
10. *J. Piskos (1896),*
11. *V. Librandit (1897),*
12. *S. Frashërit (1886),*
13. *P. Vasës (1887),*
14. *G. Benusit (1890, 1897),*
15. *D. Kolecit (1901).*

*Puna e bërë nmë fushë të botimeve gjuhësore dhe leksikografike.* Do të studiohet vepra gjuhësore dhe leksikografike e autorëve :

1. *Nikollë Gazulli*

2. *Ali Ulqinaku*
3. *Justin Rrota*
4. *Mati Logoreci*
5. *Mustafa Kruja*

*Vlerësimi i ngjarjeve shkencore me drejtim gjuhësor*

1. Shoqëritë dhe klubet për gjuhën shqipe
2. Komisia letrare shqipe e Shkodrës

*Gjurmimi dhe studimi i materialit leksikor përmes botimeve*

1. Do të vilet material nga botimet e ndryshme më me vlerë gjuhësore për pasurimin e leksikut të shqipes.
2. Do të bëhen gjurmime dhe studimi për eufemizmat e shqipes si pasuri e veçantë e leksikut të shqipes.

*Organizimi i konferencave shkencore.*

*Botimi i materialeve.*

PERSONELI I PROJEKTIT

**Personel i brendshëm i projektit**

| Nr. | Titulli/ Emri & mbiemri | Profesioni |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Artan Haxhi | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Mimoza Priku | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 3. | Prof. as. dr. Orjeta Baja | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 4. | Prof. as. dr. Rezarta Draçini | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 5. | Dr. Zamira Shkreli | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 6. | Dr. Erzen Koperaj | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 7. | Doc. Bora Logu | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 8. | Dr. Anisa Kosteri | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 9. | Dr. Merita Hysaj | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 10. | Rrezearta Murati | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| | **Personel i jashtëm i projektit** | |
| 1. | Prof. dr. Tomor Osmani | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Tefë Topalli | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 3. | Prof. dr. Francesko Altimari | Pedagog, Universiteti i Kalabrisë |
| 4. | Prof. dr. Mateo Mandala | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| 5. | Prof. dr. Bardhyl Demiraj | Pedagog, Universiteti i Mynihut |
| 6. | Prof. dr. Bardh Rugova | Pedagog, Universiteti i Prishtinës |
| 7. | Prof. dr. Leonardo Savoia | Pedagog, Universiteti i Firences |
| 8. | Prof. dr. Gjilda Alimhilli | Pedagog, Universiteti i Barit |
| 9. | Prof. dr. Shezai Rrokaj | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 10. | Prof. dr. Aljula Jubani | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 11. | Dr. Gëzim Gurga | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| | **Personel tjetër** | |
| | Doktorantët | |

## Plani afatshkurtër i punës 2021 - 2024

| Nr. | Titulli i projektit | Drejtuesi shkencor | Kohëzgjatja | Shuma që kërkohet të financohet nga buxheti i USH në vit | Shuma totale që kërkohet të financohet nga buxheti i USH |
|---|---|---|---|---|---|
| . | Fjalor historik i gjuhës shqipe (shek XVI-XIX) **(i miratuar)** | Prof. dr. Artan Haxhi | 2 vjet | Viti I **5 927 000 lekë** Viti II **1 850 000 lekë** | **7 777 000 lekë** |
| 2. | Gramatikat e shqipes të shek. XVIII – XIX. **a.** "*Kontribut me vlerë në fushë të albanologjisë*" *Gramatika e dijetarit francez Auguste Dozon (konsull i Francës në Shqipëri)* "*Manuel de la langue chkipe ou albanaise*" (1879). | Prof. dr. Artan Haxhi | 1 vit | **305 000 lekë** | **305 000 lekë** |
| 3. | Ndihmesa të autorëve shqiptarë në mërgim për zhvillimin e gjuhës shqipe në rrafshe të ndryshme gjuhësore. **a.** "*Fjalësi i veprave të A. Pipës*" | Prof. dr. Mimoza Priku | 2vjet | Viti I **130 000 lekë** Viti II **225 000 lekë** | **355 000 lekë** |
| 4. | Leksiku i veprave të Ndre Mjedës dhe rimari (K. Ashta). | Prof. dr. Artan Haxhi & Dr. Erzen Koperaj | 1 vit | **385 000 lekë** | **385 000 lekë** |
| 5. | Dom Ndoc Nikaj - Rilindasi i fundit. | Prof. dr. Mimoza Priku & Dr. Zamira Shkreli | 2 vjet | Viti I **175 000 lekë** Viti II **225 000 lekë** | **400 000 lekë** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6. | Leksiku në epikën e atë Gjergj Fishtës" ("*Lahuta e malcis*", "*Mojs Golemi*") | Prof. as. dr. Orjeta Baja | 2 vjet | Viti I<br>**185 000 lekë**<br><br>Viti II<br>**200 000 lekë** | **385 000 lekë** |
| 7. | Leksikografi me alfabetin e autorëve të veriut" (Fjalorët e shqipes të shek 19-20)<br>a. *Kontributi i dhënë nga P. Giacome Jungg në leksikografinë e shqipes "Fialuur i voghel sccyp e ltinisct mbledhur prei Jak Junkut t' Scocniis Jezu" P. Giacome Jungg Shkodër, 1895* | Prof. as. dr. Rrezarta Draçini | 2 vjet | Viti I<br>**130 000 lekë**<br><br>Viti II<br>**225 000 lekë** | **355 000 lekë** |

**Drejtuesi i projektit**

**Prof. dr. Artan HAXHI**

**II. Projekt**

## *"GRAMATIKAT E SHQIPES SHEK. XVIII – XIX"*

| *I. Emërtimi i institucionit kontraktues (Agjencisë Ekzekutuese):*<br><br>**Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*",**<br><br>A. *Nëndarja ku do të realizohet projekti:*<br><br>Fakulteti i Shkencave Shoqërore.<br>Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA),<br>Departamenti i Gjuhësisë | *Adresa:*<br><br>Sheshi "2 Prilli", Shkodër, Shqipëri<br><br>Tel. : +355 (22) 800 651<br>E-mail: info@unishk.edu.al<br>albanologjia@unishk.edu.al |
|---|---|
| | |

*Titulli i Projektit:*

## "GRAMATIKAT E SHQIPES SHEK. XVIII-XIX"

*A. Propozuar si pjesë e Programit për Kërkim e Zhvillim:*

Programi Kombëtar "***Shkencat sociale dhe albanologjike***"

*B. Objektivat e Programit të cilave u referohet Projekti:*

*Projekti ka për qëllim të nxjerrë në pah ndihmesën e autorëve shqiptarë apo të huaj në fushë të hartimit të gramatikave për shqipen të cilat nuk janë botuar në gjuhën shqipe, duke i kthyer në objekt studimi.*

*Ky projekt i madh ndahet në disa nënprojekte sipas gramatikave përkatëse që do të shqyrtohen.*

| | | |
|---|---|---|
| C. *Afati:* | *Kohëzgjatja në vite:* | **10 vjet** |

*C. PERSONELI I PROJEKTIT*

*Personel i brendshëm i projektit*

| Nr. | Titulli/ Emri & mbiemri | Profesioni |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Artan Haxhi | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Mimoza Priku | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 3. | Prof. as. dr. Orjeta Baja | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 4. | Prof. as. dr. Rezarta Draçini | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 5. | Dr. Erzen Koperaj | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 6. | Doc. Bora Logu | Punonjës shkencor pranë QSA |
| | *Personel i jashtëm i projektit* | |
| 1. | Prof. dr. Tomor Osmani | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Tefë Topalli | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 3. | Prof. dr. Francesko Altimari | Pedagog, Universiteti i Kalabrisë |
| 4. | Prof. dr. Mateo Mandala | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| 5. | Prof. dr. Bardhyl Demiraj | Pedagog, Universiteti i Mynihut |
| 6. | Prof. dr. Bardh Rugova | Pedagog, Universiteti i Prishtinës |
| 7. | Prof. dr. Leonardo Savoia | Pedagog, Universiteti i Firences |
| 8. | Prof. dr. Gjilda Alimhilli | Pedagog, Universiteti i Barit |
| 9. | Prof. dr. Shezai Rrokaj | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 10. | Prof. dr. Aljula Jubani | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 11. | Dr. Gëzim Gurga | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| | Personel tjetër | |
| | Doktorantët | |

*D. Argumentimi shkencor i Projektit..*

*a. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

**Objekti i kërkimit shkencor së bashku me tematikën e shënuar do të jenë gramatikat për gjuhën shqipe të shkruara në gjuhën shqipe apo në gjuhë të huaj. Riprodhimi, përkthimi apo sjellja në shqipen e sotme dhe studimi i tyre.**

- Projekti është i domosdoshëm të ndërmerret në këtë moment, meqë do t'u shërbejë studiuesve që në punën e tyre të pasqyrojnë ato arritje që do të sigurohen nga ky kërkim shkencor.
- Të evidentohet ndihmesa e autorëve shqiptarë e të huaj në fushë të gramatologjisë.
- Rezulatetet e këtij kërkimi do të ndihmojnë drejtëpërsëdrejti studiuesit të njihen me gramatikat e shqipes të hartuara në shek. XVIII-XIX.
- Kjo veprimtari do të bëjë të mundur që këto prodhime gjuhësore të mund të shohin dritën e botimit, për t'i radhitur pranë veprave të tjera të kësaj natyre dhe të mund t'i nënshtrohen një analize të hollë shkencore.
- Realizimi i një kërkimi të tillë do të vihet në shërbim të kërkuesve shkencorë në fushë të gjuhësisë, si brenda dhe jashtë vendit.
- Projekti duhet të financohet nga buxheti i shtetit (fondi i shkollës së lartë për kërkimin shkencor).

*E. Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*", vël. I, II, III, IV, V, VI, VII.
- Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2008;
- Tomor Osmani, *Shekulli i Komisisë Letrare Shqipe (1916-1918)*, Edlora, Tiranë, 2016;
- *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Studime shqiptare 13, Camaj Pipa, Shkodër, 2005.
- Botime të pedagogëve tanë në revistën "*Buletin shkencor*" i USH, "*Studime shqiptare*" apo edhe në revista të tjera shkencore brenda e jashtë vendit etj...

*F.* Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:


- J. Kastrati (1980), *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635 - 1944).* Prishtinë;
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë;
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër;
- Xh. Gosturani (1999), *Historia e albanologjisë*, Tiranë.
- T. Osmani (2020), *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës* (Refleksione), Botimet "Shkodra, Shkodër, 2020.
- Sektori Shkencor i Albanologjisë, *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Studime shqiptare 13, Camaj Pipa, Shkodër, 2005.


*G. Objektivat e projektit*
*Objektivi i zhvillimit:*

***Objektivi i këtij projekti është riprodhimi, transkriptimi apo përkthimi, si dhe studimi i gramatikave për shqipen të botuara apo në dorëshkrim të shek. XVIII-XIX***

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme :*

Objektivi i këtij projekti është riprodhimi, transkriptimi apo përkthimi, si dhe studimi i gramatikave për shqipen të botuara apo në dorëshkrim të shek. XVIII-XIX.

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

***Objektivi 1:** Sjell të reja shkencore në fushën përkatëse.*

*Rezultati 1: Evidentimi dhe riprodhimi i gramatikave për shqipen të hartuara në shek. XVIII-XIX, si gramatika e :*

*1. F. M. Da Lecces (1716),*
*2. W. Likut (1814),*
*3. Sh. Shkodrës (1850),*
*4. J. De Radës (1894),*
*5. O. Dozonit (1879),*

7. *H. Pedersenit (1895),*
8. *F. Rosit (1866),*
9. *G. Jungut (1880),*
10. *J. Piskos (1896),*
11. *V. Librandit (1897),*
12. *S. Frashërit (1886),*
13. *P. Vasës (1887),*
14. *G. Benusit (1890, 1897),*
15. *D. Kolecit (1901).*

*Rezultati 2: Transliterimin e transkriptimin e gramatikave të shkruara në gjuhën shqipe.*
*Rezultati 3 : Përkthimi i gramatikave të shkruara në gjuhë të huaj.*
*Rezultati 4 : Materialet e punuara do të botohen si botim më vete.*

***Objektivi 2:** Gramatikat të kthyera në shqipen e sotme do të analizohen e studiohen.*

*Rezultati 1: Evidentimi i mjeteve, formave në rrafshe të ndryshme.*
*Rezultati 2: Krahasimi i të dhënave konkrete me vepra të kësaj natyre.*
*Rezultati 3: Analiza e gramatikave*

***Objektivi 3:** Gramatikat dhe studimi i tyre do të publikohen.*

*Rezultati 1*: Rezultatet e kërkimit shkencor do të bëhen objekt i konferencave të ndryshme.
*Rezultati 2*: Rezultatet e kërkimit do të publikohen në përmbledhje të veçanta në dy pjesë:

a. Ribotimi i gramatikave,
b. Botimi i rezultateve të studimit.

---

*H. Lidhja e këtyre objektivave dhe rezultateve me projekte të tjera të ngjashme në institucionin tuaj e jashtë tij.*

Ky kërkim shkencor është vazhdim i punimeve dhe i veprimtarive të kryera ndër vite, si konferencat albanologjike: "*Gjuha dhe shkrimtari*", "*Albanologu i shquar austriak Norbert Jokli*", "*Autorët e trevës së Veriut të traditës në vështrimin gjuhësor, letrar dhe historik*", "*Identitete gjuhësore e kulturore*", "*Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu*", "*Fishta – poeti dhe mendimtari kombëtar*", "*Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" në 100-vjetorin e tij*", "*Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare*", "*Pavarësia e Shqipërisë dhe albanologjia*", "*100 vjet të revistës 'Hylli i Dritës'*", "*200 vjet me De Radën*", "*Leksikografi Tahir Dizdari dhe turkologët për shqipen*", "*Mendje të ndritura të kulturës shqiptare*", "*Personalitete të kulturës shqiptare*", "*Tomor Osmani – një jetë me albanologjinë*", "*Komisia letrare shqipe 100 vjet më pas e mendimi albanologjik*", "*Gjurmime albanologjike*", "*Kolë Ashta dhe studimet albanologjike ndër vite*" etj., po ashtu edhe i botimeve të kolanës "Studime shqiptare" (30 numra), si dhe i studimeve, monografive e artikujve të botuar në revistat "*Studime filologjike*" (Tiranë), "*Buletin shkencor*" (Shkodër), "*Gjurmime albanologjike*" dhe "*Filologjia*" (Prishtinë) etj..

*I. Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).*

Ky kërkim shkencor do të ketë tregues shumë të vlefshëm në fushë të gramatologjisë, mbasi do të paraqesë para opinionit shkencor disa vepra gramatikore të botuara në shek. XVIII-XIX, duke sjellë kontributin e autorëve shqiptarë apo të huaj në këtë fushë.
Studimi ka si qëllim final pasqyrimin e evolucionit të shqipes në rrjedhë të dy shekujve.

*J. Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*
Përftuesit direktë do të jenë punonjësit shkencorë të QSA, pedagogët e departamentit të Gjuhësisë dhe doktorantët.

*Përfituesit indirektë:*
Specialistët e gjuhës shqipe, studiuesit, pedagogët apo edhe studentë të fushës

*K. Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*
Rezultatet do të bëhen të njohura përmes botimit të punimeve në përmbedhje të posaçme apo organizimit të tubimeve me karakter shkencor.

*L. Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

*I. Plani i përgjithshëm:*
Grumbullimi dhe dixhitalizimi i gramatikave për shqipen të shek. XVIII-XIX. Për këtë do të shfrytëzohen bibliotekat, materialet arkivore apo edhe interneti. Synimi kryesor i studimit janë ato gramatika që i përkasin gegërishtes, mbasi i takon Universitetit të Shkodrës që ta ndriçojë këtë kontribut.
Përkthimi i gramatikave që janë në gjuhë të huaj.
Transkriptimi dhe transliterimi i gramatikave të shkruara në gjuhën shqipe.
Realizimi i një analize dhe i një studimi të hollësishëm për çdo gramatikë. Kur ka mundësi krahasimi, do të vihen në dukje veçantitë dhe të përbashkëtat me gramatikat e kohës apo edhe me të somet.
Periudha e zhvillimit dhe realizimit të projektit saj është 10 vjet. Ai ndahet në nënprojekte të cilat realizohen vit pas viti në periudhën shtator 2021 – shtator 2031

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**Prof. dr. Artan Haxhi**

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**
***"Luigj Gurakuqi"***
**Qendra e Studimeve Albanologjike**

**Nën-projekt**

# "KONTRIBUT ME VLERË NË FUSHË TË ALBANOLOGJISË"

**Gramatika e dijetarit francez Auguste Dozon (konsull i Francës në Shqipëri) "*Manuel de la langue chkipe ou albanaise*" (1879).**




A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:*
Pjesë e programit kombëtar "Shkencat sociale dhe albanologjike"

B. *Objektivat e programit të cilave u referohet projekti:*
**Projekti ka për qëllim të nxjerrë në pah ndihmesën e autorëve francezë në fushë të studimeve albanologjike e në veçanti të hartimit të gramatikave për shqipen, duke i kthyer në objekt studimi.**

C. *Afati: janar* *Kohëzgjatja* : 1 vit

D. *Personeli pjesëmarrës në projekt :*

| Nr. | Emri | Profesioni dhe kategoria e pagës |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Artan HAXHI | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 2. | Dr. Erzen Koperaj | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 3. | Doc. Bora Logu | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| | ***Ekspertë të jashtëm*** | |
| 3. | Prof. dr. Tomor Osmani | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 4. | Prof. as. dr. Dhurata Hoxha | Pedagoge pranë Departamentit të Romanistikës |

E. *Argumentimi shkencor i projektit..*
*Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*
Objekti i kërkimit shkencor së bashku me tematikën e shënuar do të jetë gramatika të gjuhës shqipe e autorit francez August Dozon, titulluar "*Manuel de la langue chkipe ou albanaise*" (1879), vlerësuar nga Akademia e Letërsisë e Francës me çmimin "Volnei". Do të punohet për përkthimin, sjelljen në shqipen e sotme dhe studimin e saj.

- Projekti është i domosdoshëm të ndërmerret në këtë moment, meqë do t'u shërbejë studiuesve që në punën e tyre të pasqyrojnë ato arritje që do të sigurohen nga ky kërkim shkencor.
- Të evidentohet ndihmesa e August Dozon në fushë të albanologjisë e, në veçanti, gramatologjisë.
- Rezultatet e këtij kërkimi do të ndihmojnë drejtëpërsëdrejti studiuesit të njihen me gramatikat e shqipes të hartuara në shek. XVIII-XIX.
- Ky kërkim shkencor do të bëjë të mundur që këto prodhime gjuhësore të mund të shohin dritën e botimit, për t'i radhitur pranë veprave të tjera të kësaj natyre, duke ia nënshtruar një analize të thellë shkencore.
- Realizimi i një kërkimi të tillë do të vihet në shërbim të kërkuesve shkencorë në fushë të gjuhësisë brenda dhe jashtë vendit.
- Projekti duhet të financohet nga buxheti i shtetit (fondi i shkollës së lartë për kërkimin shkencor).

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në Institutin e Studimeve Albanologjike (USH) (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*", vël. I, II, III, IV, V, VI, VII.
- Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008;
- Tomor Osmani, *Shekulli i Komisisë Letrare Shqipe (1916-1918)*, Edlora, Tiranë, 2016;
- *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Studime shqiptare 13, Camaj Pipa, Shkodër, 2005.

- Botime të pedagogëve tanë në revistën "*Buletin shkencor*" i USH, "*Studime shqiptare*" apo edhe në revista të tjera shkencore brenda e jashtë vendit etj...

G. *Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:*
- J. Kastrati (1980), *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635 - 1944)*, Prishtinë;
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë;
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër;
- Xh. Gosturani (1999), *Historia e albanologjisë*, Tiranë.
- T. Osmani (2020), *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës* (Refleksione), Botimet "Shkodra, Shkodër, 2020.
- Sektori Shkencor i Albanologjisë, *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Studime shqiptare 13, Camaj Pipa, Shkodër, 2005.

H. *Objektivat e projektit*

*Objektivi i zhvillimit:*

Objektivi i këtij projekti është përkthimi, transkriptimi dhe studimi i gramatikës së A. Dozon për shqipen.

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

***Objektivi 1:** Sjell të reja shkencore në fushën përkatëse.*

*Rezultati 1:* Evidentimi dhe riprodhimi i gramatikës së A. Dozonit për shqipen.
*Rezultati 2:* Përkthimi i gramatikës nga gjuha frënge.
*Rezultati 3 :* Transliterimi e transkriptimi e shembujve, shkruar në gjuhën shqipe nga ana e autorit.
*Rezultati 4 :* Materiali i punuar do të publikohet si botim anastatik më vete.

***Objektivi 2:** Gramatika e kthyer në gjuhën shqipe do të bëhet objekt analize.*

*Rezultati 1:* Evidentimi i mjeteve, formave në rrafshe të ndryshme
*Rezultati 2:* Krahasimi i të dhënave konkrete me vepra të tjera të kësaj natyre.

***Objektivi 3:** Gramatika dhe studimi i saj do të publikohet.*

*Rezultati 1: Rezultatet e kërkimit shkencor do të bëhen objekt i një konference shkencore.*
*Rezultati 2 : Rezultatet e kërkimit do të publikohen në përmbledhje të veçanta në dy pjesë:*
*1 Ribotimi anastatik i gramatikës.*
*2. Botimi i rezultateve të studimit.*

I. *Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).*

Ky kërkim shkencor do të ketë tregues shumë të vlefshëm në fushë të alabnologjisë, mbasi do të paraqesë para opinionit shkencor një nga veprat më të mira të gramatologjisë së gjysmës së dytë të shek. XIX. Studimi ka si qëllim final pasqyrimin e kontributit të albanologëve francezë për gjuhën shqipe, si dhe të pasqyrojë evolucionin e shqipes në rrjedhë të shekujve.

J. *Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*

Përftuesit direktë do të jenë punonjësit shkencorë të QSA, pedagogë të departamentit të Gjuhësisë dhe doktorantët .

*Përfituesit indirektë:*

Specialistët e gjuhës shqipe, studiues, pedagogë apo edhe studentë të fushës.

K. *Si mendohet t'u bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*
Rezultate do të bëhen të njohura përmes organizimit të veprimtarive shkencore dhe botimit të punimeve në përmbedhje të posaçme.

L. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, metodologjia dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

**Plani i përgjithshëm :**

Dixhitalizimi i gramatikës së August Dozon "***Manuel de la langue chkipe ou albanaise***" **(1879)**. Për këtë do të shfrytëzohet kopja e librit në Bibliotekën shkencore të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", si dhe materiale arkivore apo dokumentare.

Përkthimi i gramatikës nga frëngjishtja dhe transkriptimi e transliterimi i shembujve që janë të shkruara në shqip me alfabet me bazë latine (i ndryshëm nga alfabeti i sotëm).

Realizimi i një analize dhe i një studimi të hollësishëm, duke vënë në dukje veçantitë dhe të përbashkëtat me gramatikat e kohës apo edhe me të sotmet.

**Plani i detajuar:**

a. *Dixhitalizimi i gramatikës.*

*1 muaj*

b. *Përkthimi i gramatikës dhe transkriptimi e transliterimi i pjesës shqip.*

*11 muaj*

c. *Organizimi i një konference shkencore.*

*1 muaj*

d. *Botimi materialeve.*

*1 muaj*

## BUXHETI I PROJEKTIT

*Vlerësimi i projektit <u>për vitin e parë</u> në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

A. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet :

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Artan Haxhi | 30 % | 5 lekë/muaj x 10 muaj | 50 lekë |
| 6. | Erzen Koperaj | 30 % | 5 lekë/muaj x 10 muaj | 50 lekë |
| 8. | Bora Logu | 30 % | 5 lekë/muaj x 10 muaj | 50 lekë |

Totali i pjesshëm (A) : **150 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit) –*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| 1. | Tomor Osmani (ekspert i jashtëm) | 5 lekë/muaj x 5 muaj = 25 lekë |
| 2. | Dhurata Hoxha (ekspert i jashtëm) | 5 lekë/muaj x 5 muaj = 25 lekë |

Totali i pjesshëm: 50 mijë lekë/vit

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhëtime brenda vendit | 5 udh. x 1 lekë = 5 lekë |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : 5 mijë lekë/vit

*B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

*B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | Konferencë shkencore | 100 |

Totali i pjesshëm : **100 mijë lekë/vit**

*C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*

*C.1.Shpenzime për pajisje specifike*

- *Shpenzime kapitale*

| Nr. | Emërtimi | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| *Pajisje Profesionale* | | | | | |
| 1. | | | | | |
| *Të tjera* | | | | | |
| 1. | | | | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë:

***Vlera e plotë e projektit për vitin e parë,* në mijë lekë : 305 mijë lekë**

*Burimet e financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në %.*

| Burimet e financimit | % | në mijë lekë |
|---|---|---|
| Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese | 100 % | **305 mijë lekë** |
| | | - |
| **Gjithsej** | **100%** | **305 mijë lekë** |

| Viti i financ | Honorare studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 150 | 5 | 50 | - | 100 | 305 | - | 305 |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | Gjithsej : | 305 |

*11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese) person juridik?* **Po**

*12. Kur është i përgatitur institucioni të filloje Projektin?* ***Tetor 2021***

*13. Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen?*

Mendojme se nuk ka risqe.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

Prof. dr. Arian HAXHI

Firma Data :

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Firma Data :

## III. Projekt

# “NDIHMESA TË AUTORËVE SHQIPTARË NË MËRGIM PËR ZHVILLIMIN E GJUHËS SHQIPE NË RRAFSHE TË NDRYSHME GJUHËSORE”

| *1. Emërtimi i institucionit kontraktues (Agjencisë Ekzekutuese):*<br><br>**Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*",**<br><br>A. *Nëndarja ku do të realizohet projekti:*<br><br>Fakulteti i Shkencave Shoqërore.<br>Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA),<br>Departamenti i Gjuhësisë | *Adresa:*<br><br>Sheshi "*2 Prilli*", Shkodër, Shqipëri<br><br>Tel. : +355 (22) 800 651<br><br>E-mail: info@unishk.edu.al<br><br>albanologjia@unishk.edu.al |
|---|---|
| | |

**"NDIHMESA TË AUTORËVE SHQIPTARË NË MËRGIM PËR ZHVILLIMIN E GJUHËS SHQIPE NË RRAFSHE TË NDRYSHME GJUHËSORE"**

A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:*
Kjo fushë studimi është përcaktuar si prioritet nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor *(duke e renditur si fushën e parë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018)*, propozuar edhe si pjesë e prioriteteve strategjike të USH me Vendimin e SA nr. 97 nr. 1026 prot., datë 29. 03. 2021 ku "Studimet albanologjike" është njëri prejt tyre.

**Fusha e Kërkimit shkencor: Albanologji**

B. *Objektivat e projektit:*

Projekti ka për qëllim të nxjerrë në pah ndihmesën e autorëve shqiptarë, vepra e të cilëve për arsye të njohura nuk ka qenë aq sa duhet e njohur në Shqipëri dhe nuk është bërë e mundur që të kthehet në objekt studimi. Studimet do të kenë prurje origjinale nga rrafshe të ndryshme gjuhësore.

- Të kontribojë në njohjen e vlerave albanologjike të krijuara nga autorët shqiptarë në mërgim.
- Të vlerësojë trashëgiminë kulturore të autorëve shqiptarë në mërgim në pikëpamje gjuhësore.
- Të bëjë të njohur dhe të vlerësojë organet e botuara nga autorët shqiptarë në mërgim dhe problemet gjuhësore të diskutuara në këto organe.
- T'i promovojë këto vlera përmes punimeve shkencore e botimeve të ndryshme.

Ky projekt i madh ndahet në disa nënprojekte sipas autorëve që do të shqyrtohen.

C. *Afati* — *Kohëzgjatja* : 10 vjet

**D. Personeli i Projektit:**

| Nr. | Titulli/ Emri & mbiemri | Profesioni |
|---|---|---|
| | ***Personel i brendshëm i projektit*** | |
| 1. | Prof. dr. Mimoza Priku | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 2. | Prof. dr. Artan Haxhi | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 3. | Prof. as. dr. Orjeta Baja | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 4. | Prof. as. dr. Rezarta Draçini | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 5. | Dr. Zamira Shkreli | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 6. | Dr. Erzen Koperaj | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 7. | Doc. Bora Logu | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| | | |
| | ***Personel i jashtëm i projektit*** | |
| 1. | Prof. dr. Tomor Osmani | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Tefë Topalli | Prof. emeritus, punonjës shkencor i ftuar pranë QSA |
| 3. | Prof. dr. Francesko Altimari | Pedagog, Universiteti i Kalabrisë |
| 4. | Prof. dr. Mateo Mandala | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| 5. | Prof. dr. Bardhyl Demiraj | Pedagog, Universiteti i Mynihut |
| 6. | Prof. dr. Bardh Rugova | Pedagog, Universiteti i Prishtinës |
| 7. | Prof. dr. Leonardo Savoia | Pedagog, Universiteti i Firences |
| 8. | Prof. dr. Gjilda Alimhilli | Pedagog, Universiteti i Barit |
| 9. | Prof. dr. Shezai Rrokaj | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 10. | Prof. dr. Aljula Jubani | Pedagog, Universiteti i Tiranës |
| 11. | Dr. Gëzim Gurga | Pedagog, Universiteti i Palermos |
| | ***Personel tjetër*** | |
| | Doktorantët | |

E. **Argumentimi shkencor i Projektit.**

*Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

Nëpërmjet këtij projekti kërkimor-shkencor do të synohet të analizohen veprat letrare dhe gjuhësore apo studimore të cilat do të sillen për herë të parë nga hulumtimet për të vënë në dukje lëmenjtë shkencorë të niveleve të ndryshme, lëvruar nga personalitete me emër në fushë të letrave shqipe, që nga hartimi i fjalorëve gramatikave të panjohura, monografi si teza doktorate, vepra letrare të gjinive të ndryshme, duke i shikuar këto në rrafshe të ndryshme gjuhësore.

Projekti është i domosdoshëm të ndërmerret në këtë moment, meqë do t'u shërbejë studiuesve që në punën e tyre të pasqyrojnë ato arritje që do të sigurohen nga ky projekt. Qëllimi është të evidentohet ndihmesa e asaj „mërgate" kulturore shqiptare, duke shënuar kontributin e saj në fushë të gjuhësisë, letërsisë, kulturës shqiptare në përgjithësi. Rezultetet e këtij projekti do të ndihmojnë drejtëpërsëdrejti studiuesit e rinj, të cilët nuk e kanë njohur këtë kontribut ose e kanë njohur shumë pak. Ky projekt do të nxisë që vlerat relevante- të pohuara ndaj këtyre autorëve të mund të shohin dritën e botimit, për t'i radhitur pranë veprave të tjera të kësaj natyre. Mund do t'u shërbejë

edhe institucioneve të tjera shkencore dhe universitare, si brenda dhe jashtë vendit, kur do të merren me punime të tilla.
Që nga viti 2018 ekziston edhe një strategji kombëtare e diasporës e miratuar nga Ministria e Shtetit për Diasporën (2018-2024) që sjell në vëmendje edhe produktin kulturor të krijuar. Duke punuar edhe me vjeljen e fjalësit të veprave letrare të këtyre autorëve do të hartohen jo vetëm fjalorë për autorë të vecantë, por kjo iniciativë do të ndihmojë në hartimin e fjalorit të madh të gjuhës shqipe të tipit „thesaurus".

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në QSA dhe nw Departament (USH) (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*
- Studime shqiptare 1: *Martin Camaj – tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994, 164 f.
- Studime shqiptare 3: *Ernest Koliqi (1903 – 1975)*, Shkodër, 1995, 103 f
- Studime shqiptare 11: *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, 152 f.
- Studime shqiptare 17: *Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu*, Shkodër, 2011, 382 f.
- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Botime të pedagogëve tanë në revistën "*Buletin shkencor*" i USH, "*Studime shqiptare*" apo edhe në revista të tjera shkencore brenda e jashtë vendit etj...

G. *Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:*
- Qendra e Studimeve Albanologjike, Martin Camaj në kulturën shqiptare (në 85-vjetorin e lindjes); (aktet e konferencsë shkencore mbajtur në Tiranë më 24 shtator 2010), Tiranë 2015.
- Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar*, Tiranë, 2011.
- Hans Joachim, Lansch, *Martin Camaj ende i pazbuluem*, Tiranë, 2017.
- Anton N. Berisha, *Koliqi poet e prozator*, Cosenza, 1995.
- Laura Smaqi, *Zbulimi i vetvetes n'pasqyrë t'letravet* : (proza e shkurtër e Ernest Koliqit, Tiranë, 2009.
- Uran Kalakulla *Arshi Pipa – njeriu dhe vepra*, Tiranë: Toena, 1999.
- J. Kastrati (1980), *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635 - 1944)*, Prishtinë;
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë;
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër;
- T. Osmani (2020), *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës* (Refleksione), Botimet "Shkodra, Shkodër, 2020 etjs.

H. *Objektivat e projektit*

*Objektivi i zhvillimit:*

Krijimi i një kuadri të përgjithshëm rreth kontributit të autorë shqiptarë në mërgim në lëmë të gjuhësisë, letërsisë dhe çështjet gjuhësore të trajtuara prej tyre e studim i gjuhës së veprës së tyre.

a. *Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

*Objektivi 1:*

Njohja me autorët, veprat e tyre të botuara në shqip apo në gjuhë të huaj si dhe vepra të lëna në dorëshkrim.

*Rezultati 1:* Krijimi i një baze të detajuar të dhënave në lidhje autorët, veprimtarinë e tyre, veprat e tyre.

*Rezultati 2:* Ndriçimi i autorëve shqiptarë në mërgim në fushën e gjuhësisë, si A. Pipa, E. Koliqi, K. Gurakuqit, N. Resuli, M. Camaj, S. Rrepishti etj.

*Objektivi 2:*

Vepra letrare dhe gjuha e saj në rrafsh fjalëformimi, sintaksor, sociolinguistik, pragmatik, etnolinguistik, psikolinguistik etj.

*Rezultati 1:* Krahasimi i të dhënave konkrete me vepra të kësaj natyre brenda vendit.
*Rezultati 2:* Evidentimi i mjeteve, formave, prurjeve të reja në këto rrafshe.

*Objektivi 3:*

Evidentimi gramatikave e fjalorëve të haruara në diasporë dhe koherenca e tyre.

*Rezultati 1:* Analiza e gramatikave të K. Gurakuqit, N. Resulit, M. Camajt, etj.
*Rezultati 2:* Evidentimi i vlerave dhe analiza e fjalorëve të K. Gurakuqit, L. Marlekës etj.

*Objektivi 4:*

Fjalësi e veprave letrare të autorëve në mërgim.

*Rezultati 1:* Vjelja e fjalësit te krijimtaria e A. Pipës, E. Koliqit, M. Camajt, S. Rrepishtit etj.
*Rezultati 2:* Hartimi i fjalorëve të autorëve të veçantë. etj.

---

I. *Lidhja e këtyre objektivave dhe rezultateve me projekte të tjera të ngjashme në institucionin tuaj e jashtë tij.*

Ky kërkim shkencor është vazhdim i punimeve dhe i veprimtarive të kryera ndër vite, si konferencat albanologjike: *"Gjuha dhe shkrimtari", "Autorët e trevës së Veriut të traditës në vështrimin gjuhësor, letrar dhe historik", "Identitete gjuhësore e kulturore", "Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu", "Fishta – poeti dhe mendimtari kombëtar", "Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" në 100-vjetorin e tij", "Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare", "Pavarësia e Shqipërisë dhe albanologjia", "100 vjet të revistës 'Hylli i Dritës'", "200 vjet me De Radën", "Leksikografi Tahir Dizdari dhe turkologët për shqipen", "Mendje të ndritura të kulturës shqiptare", "Personalitete të kulturës shqiptare", "Tomor Osmani – një jetë me albanologjinë", "Komisia letrare shqipe 100 vjet më pas e mendimi albanologjik", "Gjurmime albanologjike", "Kolë Ashta dhe studimet albanologjike ndër vite" etj., po ashtu edhe i botimeve të kolanës "Studime shqiptare" (30 numra), si dhe i studimeve, monografive e artikujve të botuar në revistat "Studime filologjike" (Tiranë), "Buletin shkencor*" (Shkodër), "*Gjurmime albanologjike*" dhe "*Filologjia*" (Prishtinë) etj..

---

J. *Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).*

Ky kërkim shkencor do të ketë tregues shumë të vlefshëm në fushë të studimit të gegërishtes dhe të evidentimit të evoluimit të saj nga njëri autor tek tjetri. Ky projekt synon ndriçmin e kontributit të autorëve në mërgim për gjuhën shqipe dhe lëvrimin e saj përmes veprave letrare dhe përkthimeve, si dhe teksteve të gramatikave.

K. *Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*

Përftuesit direktë do të jenë punonjësit shkencorë të QSA, pedagogët e departamentit të Gjuhësisë dhe doktorantët.

*Përfituesit indirektë:*

Specialistët e gjuhës shqipe, studiuesit, pedagogët apo edhe studentë të fushës.

L. *Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*

Nëpërmjet organizimit të konferencave dhe publikimeve shkencore në lidhje me rezultatet e arritura

M. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

Grumbullimi dhe dixhitalizimi i veprave letrare të autorëve që do të merren në shqyrtim për hartimin e fjalësve të autorëve të veçantë. Mbledhja e manualeve gramatikore dhe puna me to.

Për këtë do të shfrytëzohen bibliotekat, materialet arkivore apo edhe interneti. Synimi kryesor i studimit është evidentimi i pasurisë leksikore e gramatikore të gegërishtes, mbasi i takon Universitetit të Shkodrës që ta ndriçojë këtë kontribut.

Pas dixhializimit të veprave letrare do të merret në shqyrtim i gjithë fjalësi për t'u pajisur me kuptime, shënime dhe shembuj konkretë. Nëpërmejt kësaj pune do të dalin veçantitë e njërit apo tjetrit autor.

Do të analizohen gramatikat dhe veprat me karakter gjuhësor të hartuara nga autorët në mërgim.

Periudha e zhvillimit dhe realizimit të projektit saj është 10 vjet. Ai ndahet në nënprojekte të cilat realizohen vit pas viti në periudhën shtator 2021 - shtator 2031

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**Prof. dr. Mimoza Priku**

# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*
### FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
### QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
### DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

## Programi i doktoraturës "*Gjuhë shqipe*"

**Nën-projekt**

**"FJALËSI I VEPRAVE TË ARSHI PIPËS"**

A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:*
Kjo fushë studimi është përcaktuar si prioritet nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor *(duke e renditur si fushën e parë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018)*, propozuar edhe si pjesë e prioriteteve strategjike të USH me Vendimin e SA nr. 97 nr. 1026 prot., datë 29. 03. 2021 ku "Studimet albanologjike" është njëri prej tyre.

**Fusha e Kërkimit shkencor: Albanologji**

B. *Objektivat e projektit:*

Projekti ka qëllim vjeljen e fjalësit të plotë të veprave të Arshi Pipës me perspektivën e hartimit të fjalorit të këtij autori duke dhënë një kontribut në zhvillimin e leksikografisë tekstore. Ky projekt, së bashku me projektet e tjera të kësaj natyre, do të kontribojnë në hartimin e fjalorit "*thesaurus*" të gjuhës shqipe.

- Të kontribojë në njohjen e vlerave gjuhësore të krijuara nga një prej autorëve të njohur shqiptarë në mërgim, Arshi Pipës.
- Të vlerësojë trashëgiminë gjuhësore të Arshi Pipës duke e parë evoluimin në kohë dhe hapësirë të saj.
- Të kontribojë në filologjinë dhe leksikografinë tekstore të gjuhës shqipe.
- Të hartojë fjalësin e plotë të veprave të Arshi Pipës.

C. *Afati:* *Kohëzgjatja* : 2 vite

**D. Personeli i Projektit:**

| Nr. | Emri | Profesioni dhe kategoria e pagës |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Mimoza Priku | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 2. | Prof. as. dr. Rrezarta Draçini | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 3. | Dr. Aida Uruçi | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 4. | Dr. Anisa Kosteri | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 5. | Dr. Rezearta Murati | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| | ***Ekspertë të jashtëm*** | |
| 1. | Francesko Altimari | Universiteti i Kalabrisë |
| 2. | Prof. dr. Mateo Mandala | Universiteti i Palermos |
| 3. | Dr. Gëzim Gurga | Universiteti i Palermos |

E. **Argumentimi shkencor i Projektit.**

*Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

Ky projekt si pjesë e një projekti më të gjerë me titull "Ndihmesa të autorëve shqiptarë në mërgim për zhvillimin e gjuhës shqipe në rrafshe të ndryshme gjuhësore" synon vjeljen e plotë me metoda moderne të filologjisë tekstore të fjalësit të veprave të Arshi Pipës duke synuar hartimin e fjalorit të këtij autori.

Hartimi i fjalësit të autorëve të veçantë është puna më imediate në leksikografinë shqipe, duke qenë se Akademia e Shkencave të Shqipërisë po punon me projektin e madh për hartimin e fjalorit me 90 000 fjalë dhe me rreth 10.000 njësi frazeologjike. Fjalësi i veprave të Arshi Pipajt dhe i autorëve të tjerë që do të hartohen janë një bazë e mirë për fjalorin e madh. Është zgjedhur Arshi Pipa sepse ai ka hyrë në historinë e kulturës sonë si poet, përkthyes, estet dhe studiues. Arshi Pipa ka botuar shumë vepra, përkthime dhe studime në italisht dhe anglisht. Në shqip trashëgojmë këto vepra letrare:

- *Lundërtare*, Tiranë, 1944, ribotim Tiranë, 2010 ;
- *Libri i burgut*, Romë, 1959 , italisht, Tiranë, 1994 shqip;
- *Rusha*. Mynih, 1968, Tiranë, 1995 shqip;
- Përmbledhje e veprës letrare në shqip nga shtëpia botuese "*Plejad*" në katër vëllime:
- Vëllimi I: *Lundërtarë dhe Libri i dashunis dhe i fatit, Tiranë*, 2010, 142 f.
- Vëllimi II: *Autobiographia*, 1998, Tiranë 2010, 101 f.
- Vëllimi III: *Lyrika latine* (përkthyer në shqip dhe paraqitur nga Arshi Pipa), Tiranë, 2010, 296 f.
- Vëllimi IV : *Lyrika evropiane moderne* (përkthyer në shqip nga autori), Tiranë, 2010, 148 f.

Fjalori do të regjistrojë pasurinë e fjalëve, frazeologjisë së leksikut të përdorur nga Arshi Pipa duke parë edhe evoluimin e gjuhës. Pas botimit të "*Fjalorit historik*" të Kolë Ashtës me 7 vëllime, përpunimit të "*Fjalorit të Ndre Mjedjes dhe rimarit*" të hartuar nga Kolë Ashta, do të vijojë puna me hartimin e fjalorit historik të shqipes sipas Kolë Ashtës dhe fjalorëve të autorëve të veçantë. Fjalori i Arshi Pipës do të jetë shpjegues dhe do të evidentohen në këtë mënyrë kuptimet e ndryshme të fjalëve.

Në këtë mënyrë ky kuntribut mund do t'u shërbejë edhe institucioneve të tjera shkencore dhe universitare, si brenda dhe jashtë vendit, kur do të merren me punime të tilla.

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në QSA dhe në Departament (USH) (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*". vël. I, II, III, IV, V, VI, VII. [illegible] Shqipërisë, Tiranë, 2008;

- *Studime shqiptare 14:* "Autorët e trevës së Veriut të traditës në vështrimin gjuhësor, letrar dhe historik & 100-vjetori i botimit të këngës "Te ura e Rrzhanicës" e atë Gjergj Fishtës, Shkodër, 311 f.
- *Studime shqiptare 25:* "Mendje të ndritura të kulturës shqiptare (Anton Xanoni dhe Justin Rrota) & Personalitete të kulturës shqiptare (Ndoc Nikaj, Faik Konica, Vinçens Prenushi, Hilë Mosi)", Shkodër, 2017, 401 f.
- *Studime shqiptare 29:* "Gjurmime albanologjike (Hulumtime për ndihmesat e disa albanologëve në kulturën shqiptare)", Shkodër, 2019, 312 f.

G. *Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:*

- Uran Kalakulla *Arshi Pipa – njeriu dhe vepra*, Tiranë: Toena, 1999. Sami Repishti, Me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes :Shoku im Arshi Pipa, *Phoenix*, Nr. 3-4, 1998, f.33-40
- P. Asllani-Dh. Shehri, "Pipa lexues i përjetshëm i Milosaos", *Studime albanologjike* : organ shkencor i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Nr. 2, 2014, f.20-28.
- Alfred Çapaliku, Riardhja në kohë e një libri poetik të Arshi Pipës, *Buletin shkencor* : seria e shkencave shoqërore, Nr. 60, 2010, f.123 - 126.
  Tefë Topalli, Arshi Pipa dhe vepra e tij "Trilogjia Albanika, *Buletin shkencor* : seria e shkencave shoqërore, Nr. 64, 2014, f.337 - 341.
- Kristina Jorgaqi, *Fjalor i shqipes i Faik Konicës*, Tiranë, 2020.
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë;
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër;
- Xh. Gosturani (1999), *Historia e albanologjisë*, Tiranë.
- T. Osmani (2020), *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës* (Refleksione), Botimet "Shkodra, Shkodër, 2020.

H. *Objektivat e projektit*

*Objektivi i zhvillimit:*

Hartimi i fjalësit të Arshi Pipës do të pasqyrojë pasurinë e çmuar të shqipes në përgjithësi dhe të gegërishtes në vecanti. Ai do të hartohet mbi bazën e parimeve bashkëkohore të leksikografisë duke përdorur programe kompjuterike të avancauara. Ky fjalës do të na ndihmojë për të kuptuar evoluimin e fjalëve, kuptimeve dhe gjuhës në përgjithësi.

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

*Objektivi 1:*

Njohja me veprat e Arshi Pipës të botuara në gjuhën shqipe si dhe vepra të lëna në dorëshkrim. Hartimi i parimeve bazë dhe e metodologjisë për vjeljen e këtij fjalësi.

*Rezultati 1:* Krijimi i një baze të detajuar të dhënave në lidhje me personalitetin e Arshi Pipës, veprimtarinë letrare dhe publicistike. Evidentimi i veprave dhe përkthimeve e tij.

*Rezultati 2:* Përcaktimi i hapave të punës dhe ndarja e saj në mes anëtarëve të grupit të punës.

*Objektivi 2:*

Krijimi i një baze të përgjithshme nga fjalësi i veprave letrare dhe e përkthimeve të Arshi Pipës.

*Rezultati 1:* Krahasimi i fjalëve në kontekste të ndryshme përmes shembujve konkretë nga vepra e Arshi Pipës.

*Rezultati 2:* Evidentimi i fjalësi të përgjithshëm nga ai i krijuar nga autori.

*Objektivi 3:*

Hartimi i fjalësit të Arshi Pipës.

*Rezultati 2:* Redaktimi, unifikimi, plotësimi, korrektimi në vazhdimësi i fjalësit.

I. *Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).*

***Fjalësi i veprave të Arshi Pipës*** është një vepër e munguar në leksikografinë shqipe, prandaj do të jetë një ndihmë e e madhe për gegërsihten dhe gjuhën shqipe e pse jo edhe një mbështetje për pasurimin e Fjalorit të madh të gjuhës shqipe. Ky fjalës do të pasqyrojë pasurinë e shqipes në lema dhe kuptime dhe do të ndihmojë në pasurimin e standardit të shqipes. Do t`u shërbejë studentëve dhe albaologëve.

J. *Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*

Përfituesit direktë do të jenë punonjësit shkencorë të QSA-së, pedagogët e departamentit të Gjuhësisë dhe doktorantët.

*Përfituesit indirektë:*

Specialistët e gjuhës shqipe, studiues, pedagogë, studentë të fushës së gjuhësisë.

K. *Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*

Nëpërmjet publikimeve shkencore ne lidhje me rezultatet e arritura

L. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar, metodologjia dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

**Plani i përgjithshëm** :

Hartimi i Fjalësit të veprave të Arshi Pipës. Për këtë do të shfrytëzohen botimet në Bibliotekën shkencore të Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", si dhe materiale arkivore apo dokumentare.

Dixhitalizimi, përpilimi i fjalësit, shpjegimi i kuptimeve.

Pajisja me shënime dhe shembuj për secilën lemë.

***Plani i detajuar*:**

a. Hartimi i dhe diskutimi i "Parimeve e i kritereve të fjalësit". *1 muaj.*

b. Dixhitalizimi i veprave të Arshi Pipës. *5 muaj.*

c. Përpilimi i fjalësit të veprave. *12 muaj.*

d. Shpjegimi i kuptimeve, redaktimi, plotësimi. *4 muaj.*

e. Organizimi i një konference shkencore. *2 muaj.*

## BUXHETI I PROJEKTIT

*Vlerësimi i projektit **<u>për vitin e parë</u>** në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

A. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet :

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Mimoza Priku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 2. | Rrezarta Draçini | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 3. | Aida Uruçi | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 4. | Anisa Kosteri | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 5. | Rezearta Murati | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| | | | | |

Totali i pjesshëm (A) : **125 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit) –*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhëtime brenda vendit | 5 udh. x 1 lekë = 5 lekë |

Totali i pjesshëm : **5 mijë lekë/vit**

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

*C.1.Shpenzime për pajisje specifike*

- Shpenzime kapitale

| Nr. | Emërtimi | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| *Pajisje Profesionale* | | | | | |
| 1. | | | | | |
| *Të tjera* | | | | | |
| 1. | | | | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë:

***Vlera e plotë e projektit për vitin e parë* : 130 mijë lekë**

*Burimet e financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në %.*

| Burimet e financimit | % | në mijë lekë |
|---|---|---|
| Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese | 100 % | 130 |
| | | - |

Totali i pjesshëm : **130 mijë lekë/vit**

*Vlerësimi i projektit **për vitin e dytë** në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

B. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet :

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Mimoza Priku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 2. | Rrezarta Draçini | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 3. | Aida Uruçi | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 4. | Anisa Kosteri | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 5. | Rezearta Murati | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| | | | | |

Totali i pjesshëm (A) : **125 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit)* -

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | Konferencë shkencore | 100 |

Totali i pjesshëm : **100 mijë lekë/vit**

| Viti i financ | Honorare studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti I** | 125 | 5 | - | - | | 130 | - | 130 |
| **Viti II** | 125 | - | - | - | 100 | 225 | - | 225 |
| **Gjithsej :** | | | | | | | | **355 mijë lekë** |

*11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese) person juridik?* **Po**

*12. Kur është i përgatitur institucioni të filloje Projektin?* ***Tetor 2021***

*13. Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen?*

Mendojme se nuk ka risqe.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

Prof. dr. Mimoza PRIKU

Firma Data :

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Firma Data :

## IV. Projekt

## “LEKSIKU I VEPRAVE TË NDRE MJEDËS DHE RIMARI”

## (K. ASHTA)

# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*
### FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
**Qendra e Studimeve Albanologjike**


# "LEKSIKU I VEPRAVE TË NDRE MJEDËS DHE RIMARI"
# (K. ASHTA)

A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:* Kjo fushë studimi është përcaktuar si prioritet nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor *(duke e renditur si fushën e parë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018)*, propozuar edhe si pjesë e prioriteteve strategjike të USH me Vendimin e SA nr. 97 nr. 1026 prot., datë 29. 03. 2021 ku "Studimet albanologjike" është njëri prejt tyre.

**Fusha e kërkimit shkencor : Albanologji**

B. *Objektivat e programit të cilave u referohet projekti:*
1. Hartimi i fjalësit të plotë të veprës letrare, didaktike, fetare, studimore të Ndre Mjedës.
2. Ruajtja e leksikut të gegërishtes, një pjesë e të cilit me kalimin e kohës dhe nën presionin e standardit ka humbur dhe po humb dita-ditës.
3. Pasurimi i fjalorit të shqipes së sotme me fjalë të burimit autokton.

C. *Afati :* *Kohëzgjatja :* 1 vit

**D. Personeli i Projektit:**

| Nr. | Emri | Profesioni dhe kategoria e pagës |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Artan HAXHI | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 2. | Prof. dr. Mimoza PRIKU | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 3. | Dr. Zamira SHKRELI | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 4. | Dr. Erzen KOPERAJ | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 5. | Doc. Bora LOGU | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 6. | Prof. dr. Alfred ÇAPALIKU | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 7. | Dr. Ermira ALIJA | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| | ***Ekspertë të jashtëm*** | |
| 1. | Prof. dr. Francesco ALTIMARI | Universiteti i Kalabrisë |
| 2. | Prof. dr. Gjilda ALIMHILLI | Universiteti i Barit |

E. *Argumentimi shkencor i Projektit.*

*Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

Ndre Mjedja mbetet një prej mjeshtrave të më të mëdhenj të formës e të gjuhës poetike dhe i tingëllimit në shqip. Vepra e tij përfshin një sërë fushash, jo vetëm atë letrar dhe fetar, por edhe didaktik, studimor (gjuhësi) dhe politik. Kjo bën që dhe fjalësi i veprës së tij të jetë i larmishëm dhe të prekë shumë sfera të jetës, çka nuk ndeshet në shumë autorë të tjerë. Studimi i fjalësit të veprës së Mjedës, jo vetëm që nuk është botuar ndonjëherë më parë (kemi vetëm një punim në dorëshkrim të studiuesit Kolë Ashta), por paraqet interes të veçantë për pasurinë leksikore të shqipes në përgjithësi dhe të gegërishtes në veçanti. Mjeda, duke qenë jo vetëm poet, por ndryshe nga shumë shkrimtarë të tjerë shqiptarë të asaj periudhe, e më pas ka qenë gjuhëtar dhe njohës i gjuhës së popullit, të cilën ai e ka mbledhur dhe përfshirë në veprën e tij. Vlera e këtij fjalori është e një rëndësie të dorës së parë në mbrojtjen e kulturës shkrimore të shkruar në shqipen veriore, në gegërishte. Mendojmë se leksiku i Mjedës duhet t'i kalojë mbi pesë mijë njësi leksikore, por është mëse e nevojshme që të bëhet jo vetëm "*inventari*" i fjalëve që do të përfshijë, por edhe e zbërthimit kuptimor i fjalëve, ilustrimi me thënie e me shembuj burimorë nga tekstet e Mjedës, referimet për lidhjet sinonimike, atonimike, shënimet përkatëse gramatikore, stilistike, shpesh herë edhe etimologjike, duke i krahasuar edhe me gjuhët e huaja fqinje ose në kontakt me shqipen. Realizimi i një vepre mbi fjalësin e N. Mjedës e bëjnë të mundshëm tashmë disa faktorë, si mbledhja e gjerë e lëndës leksiko-frazeologjike e semantike të veprës së Mjedës realizuar nga qendra jonë (duke pasur si pike referimi punën e prof. Kolë Ashtës), studimi i veprës së tij në shumë aspekte dhe përvoja e krijuar nga ky institucion në hartimin e fjalorëve të tillë (mjafton të kujtojmë shtatë vëllimet e "Leksikut historik" të përgatitura gjatë nga kjo qendër).

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucione të tjera (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.

- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*", vël. I, II, III, IV, V, VI, VII.

G. *Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:*

- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*", vëll. I, II, III, IV, V, VI, VII (1995 – 2017).
- Fjalor i gjuhës shqipe (Fjaluer i Rii i shcypes – perbaam preie Shocniiet t'Bashkimit – 1908), botim anastatik, botimet Fishta, 2018.
- Thoma Qendro (2014), *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut*, Tiranë.
- Thimi Mitko (2014), *Fjalëtore shqip – gërqisht, gërqisht-shqip, Tiranë.*
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër.

H. *Objektivat e projektit*

*Objektivi i zhvillimit:*

Objektivi i këtij projekti është digjitalizimi dhe përgatitja për botim i dorëshkrimit të Kolë Ashtës "*Fjalor i veprave të Ndre Mjedës dhe rimari*".

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

***Objektivi 1:** Sjell të reja shkencore në fushën përkatëse.*

*Rezultati 1:* Evidentimi dhe kompjuterizimi i materialeve në dorëshkrim.
*Rezultati 2:* Korrigjimi i materialit dhe ballafaqimi me origjinalin e veprave të N. Mjedës
*Rezultati 3:* Studimi dhe shoqërimi me shënime e sqarime.
*Rezultati 4 :* Materiali i punuar do të publikohet si botim më vete.

***Objektivi 2:** Fjalësi do të bëhet objekt analize.*

*Rezultati 1:* Evidentimi i i fjalëve sipas shtresave të ndryshme.
*Rezultati 2:* Krahasimi i të dhënave konkrete me vepra të tjera të kësaj natyre.

***Objektivi 3:** Fjalori dhe studimi i saj do të publikohen.*

*Rezultati 1: Rezultatet e kërkimit shkencor do të bëhen objekt i një konference shkencore.*
*Rezultati 2 : Rezultatet e kërkimit do të publikohen në përmbledhje të veçanta në dy pjesë:*

*a. Botimi i Fjalorit dhe i rimarit.*
*b. Botimi i rezultateve të studimit.*

I. *Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara.*
Ky kërkim shkencor do të ketë tregues shumë të vlefshëm në fushë të albanologjisë, mbasi do të paraqesë para opinionit shkencor Fjalësin e njërit prej autorëve kryesorë të traditës, i përbërë nga rreth 5800 njësi leksikore. Studimi ka si qëllim final pasqyrimin e kontributit të njërit prej shkrimtarëve kryesorë të traditës shkrimore të Qarkut letrar të Veriut, siç është Ndre Mjeda në pasurimin e gjuhës shqipe, si dhe të pasqyrojë evolucionin e shqipes në rrjedhë të kohës.

J. *Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*

Përftuesit direktë të këtij studimi mendojmë se do të jenë së pari mësuesit e letërsisë dhe nxënësit e shkollave, pasi nuk mund të ketë një mësim të nivelit të duhur në lëndën e letërsisë mbi N. Mjedën, pa kuptuar mire fjalët dhe nauancat e tyre stilistikore në veprën e tij (hulumtime të vetë institucioneve arsimore e kanë evidentuar një problem të tillë me autorët gegë të traditës; shih më gjerësisht dhe *Standarde për tekstet shkollore*, MASH, 2015.); studiuesit e fushave gjuhësi, letërsi dhe publicistikë, punonjësit e Qendrave të Studimeve Albanologjike (brenda dhe jashtë vendit).

*Përfituesit indirektë:*

Studiues të disiplinave të tjera të interesuar për këtë studim, studentet aspirantë për doktoraturë dhe "Master shkencor" në degët e hulumtuara në këtë studim.

K. *Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*
Nëpërmjet botimit shkencor të leksikut të Mjedës, si dhe përmes një konference shkencore mbi rezultatet e arritura, si dhe publikimeve gjatë realizimit të fazave të projektit.

L. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar për vitin e parë, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

*Plani i përgjithshëm:*

- Digjitalizimi i materialit në dorëshkrim (655 faqe);
- Ndarja e shkronjave dhe fillimi i punës përzgjedhëse;
- Hartimi i një shkronje si gjedhe / model pune;
- Hartimi i veprës;
- Redaktim, unifikim, plotësim, korrektim në vazhdimësi;
- Botimi i veprës;
- Konferencë shkencore për njohjen me rezultatet.

*Plani i i detajuar i punës*

- Digjitalizimi i materialit në dorëshkrim (655 faqe); *1 muaj*
- Redaktim, unifikim, plotësim, korrektim në vazhdimësi; *10 muaj*
- Botimi i veprës; *1 muaj*
- Konferencë shkencore. *1 muaj*

## BUXHETI I PROJEKTIT

*Vlerësimi i projektit **për vitin e parë** në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

A. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet :

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Artan Haxhi | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 2. | Mimoza Priku | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 3. | Zamira Shkreli | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 4. | Erzen Koperaj | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 5. | Bora Logu | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 6. | Alfred Çapaliku | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |
| 7. | Ermira Alija | 30 % | 4 lekë/muaj x 10 muaj | 40 lekë |

Totali i pjesshëm (A) : **280 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhëtime brenda vendit | 5 udh. x 1 lekë = 5 lekë |

Totali i pjesshëm : **5 mijë lekë/vit**

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | Konferencë shkencore | 100 |

Totali i pjesshëm : **100 mijë lekë/vit**

C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

*C.1.Shpenzime për pajisje specifike*

- Shpenzime kapitale

| Nr. | Emërtimi | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| | | *Pajisje Profesionale* | | | |
| 1. | | | | | |
| | | *Të tjera* | | | |
| 1. | | | | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë:

*Vlera e plotë e projektit për vitin e parë*, në mijë lekë : **385 mijë lekë**

*Burimet e financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në %.*

| Burimet e financimit | % | në mijë lekë |
|---|---|---|
| Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese | 100 % | **385 mijë lekë** |
| **Gjithsej** | **100%** | **385 mijë lekë** |
| | | |

| Viti i financ | Honorare studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti I** | 280 | 5 | - | - | 100 | 385 | - | 385 |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | **Gjithsej :** | **385 mijë lekë** |

*11. A është institucioni (Agjensia ekzekutuese) person juridik?* **Po**

*12. Kur është i përgatitur institucioni të filloje Projektin?* ***Tetor 2021***

*13. Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen?*

Mendojme se nuk ka risqe.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

Prof. dr. Artan HAXHI

Dr. Erzen KOPERAJ

Firma Data :

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Firma Data :

| Viti i financ | Honorare studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti I** | 280 | 5 | - | - | 100 | 385 | - | 385 |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | **Gjithsej :** | **385 mijë lekë** |

*11. A është institucioni (Agjensia ekzekutuese) person juridik?* **Po**

*12. Kur është i përgatitur institucioni të fillojë Projektin?* ***Tetor 2021***

*13. Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen?*

Mendojme se nuk ka risqe.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

Prof. dr. Artan HAXHI

Dr. Erzen KOPERAJ

Firma Data :

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Firma Data :

# V. Projekt

## “DOM NDOC NIKAJ - RILINDASI I FUNDIT”

## (K. ASHTA)

# UNIVERSITETI I SHKODRËS
## *"Luigj Gurakuqi"*
## FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
## QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
## DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

# Programi i doktoraturës "*Gjuhë shqipe*"

## "DOM NDOC NIKAJ - RILINDASI I FUNDIT"

A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:*
Kjo fushë studimi është përcaktuar si prioritet nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor *(duke e renditur si fushën e parë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018)*, propozuar edhe si pjesë e prioriteteve strategjike të USH me Vendimin e SA nr. 97 nr. 1026 prot., datë 29. 03. 2021 ku "Studimet albanologjike" është njëri prejt tyre.

Fusha e Kërkimit shkencor: **Albanologji**

B. *Objektivat e projektit:*

Ky projekt synon të studiojë e të nxjerrë të plotë kontributin real të Dom Ndoc Nikajt në këto fusha:
Të studiojë gjuhën e shkruar në 15 vepra të Nikajt në të cilën përfshihen libra shkollorë, letrarë dhe fetarë të autorit.

- Të analizojë korpusin e veprave nga pikëpamja gjuhësore në rrafshin leksikor e sintaksor.
- Të realizojë vjeljen e materialit dhe të bëjë analizën në sistemin fonetik, morfologjik e pjesërisht në atë leksikor.
- Të realizojë vjeljen e veçantive didaktike e metodike, vështruar në të gjitha sistemet e nënsistemet e gjuhës shqipe, në tekstet shkollore të autorit, duke u ndalur në parimin metodik: gjuha amtare si burimi e pikëlidhja e të gjitha disiplinave shkollore.

C. *Afati:* *Kohëzgjatja* : 2 vite

**D. Personeli i Projektit:**

| Nr. | Emri | Profesioni dhe kategoria e pagës |
|---|---|---|
| 1. | Prof. dr. Mimoza Priku | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 2. | Dr. Zamira Shkreli | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 3. | Doc. Bora Logu | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 4. | Dr. Anisa Kosteri | Pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë |
| 5. | Prof. dr. Alfred Çapaliku | Punonjës shkencor pranë QSA |
| 6. | Dr. Ermira Alija | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| 7. | Dr. Isida Hoxha | Punonjëse shkencore pranë QSA |
| | ***Ekspertë të jashtëm*** | |
| 1. | Prof. dr. Shezai Rrokaj | Universiteti i Tiranës |
| 2. | Prof. dr. Aljula Jubani | Universiteti i Tiranës |
| 3. | Prof. dr. Bardhyl Demiraj | Universiteti i Mynihut |

E. **Argumentimi shkencor i Projektit.**

Studimet albanologjike, vlerësimi dhe promovimi i trashëgimisë materiale e shpirtërore shqiptare është një prej prioriteteve, si një ndër dëshmitë e qenësishme e më shprehëse të identitetit shqiptar. Ato janë cilësuar si prioritet edhe nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor (*duke e renditur si fushën e parë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018*). Një prej elementeve më të rëndësishëm në këtë këndvështrim mbesin autorët e Veriut, të cilët përbëjnë vijën e pandërprerë të kulturës shkrimore shqiptare që nga zanafilla e saj (në shek.XVI) e në vijim. Mjaft prej këtyre autorëve, për shkak të rrethanave historiko-politike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, u anashkaluan, në mjaft raste u denigruan dhe vepra e tyre ende sot e kësaj dite mbetet pjesërisht e panjohur dhe e pastudiuar, duke qenë humbësit e mëdhenj të kulturës tonë. Një prej shembujve më të qartë në këtë pikëvështrim mbetet Dom Ndoc Nikaj, i njohur si babai i romanit shqiptar, ndër autorët më prodhimtarë, i cili për mëse 50 vite me radhë punoi duke lëvruar gjuhën shqipe dhe për ringjalljen e idesë kombëtare, për të forcuar identitetin etnik e shpirtëror. Ky studim vjen si një bashkëpunim midis QSA-së dhe departamenti të gjuhësisë, të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për dy arsye: së pari sepse një pjesë e mirë e stafit janë gegërishtfolës. Së dyti, duke njohur në një shkallë mjaft të mirë gegërishten dhe veçoritë e saj gjuhësore, dhe letrare të Ndoc Nikajt, intrigohemi si institucion të angazhohemi në studimin gjuhësor, letrar, publicistik dhe historik të kësaj figure kolosale.

N. Nikaj mund të quhet një *apostull i kulturës shqiptare*, sepse dha çdo gjë në shërbim të idesë kombëtare, jo vetëm me veprën e tij shkrimore, por duke u angazhuar vetë personalisht në kuvende e organizime kryengritjesh. Shkrimet e tij (prozë edhe vargje), në letërsi, histori e publicistikë, janë një pjesë e kulturës sonë që kanë nevojë të nxirren në dritë, për të rindërtuar atë hallkë pa të cilën kultura shqiptare shqiptare nuk mund të ketë dimensionin e saj historik shekullor.

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në QSA dhe në Departament (USH) (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

- Kolë Kamsi, "*Fjalor i arbërishtes*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Kamsi "*Shqiptarët e Italisë*", botim i Sektorit Shkencor të Albanologjisë, Universiteti i Shkodrës, 2000.
- Kolë Ashta, "*Leksiku historik i gjuhës shqipe*", vël. I, II, III, IV, V, VI, VII.
- Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008;
- Tomor Osmani, *Shekulli i Komisisë Letrare Shqipe (1916-1918)*, Edlora, Tiranë, 2016;
- Botime të pedagogëve tanë në revistën "*Buletin shkencor*" i USH, "*Studime shqiptare*" apo edhe në revista të tjera shkencore brenda e jashtë vendit etj...

G. *Referime kryesore të literaturës në lidhje me problemin:*


- J. Kastrati (1980), *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635 - 1944)*, Prishtinë;
- J. Kastrati (2000), *Historia e albanologjisë* (1497-1997), Tiranë;
- T. Osmani (2008), *Udha e shkronjave shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë;
- Markus W. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për lëvizjen kombëtare, arsimin dhe kulturën*", Tiranë, 2016.
- T. Osmani (2006, 2007, 2009, 2014), *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, Shkodër;
- T. Osmani (2020), *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës* (Refleksione), Botimet "Shkodra, Shkodër, 2020.
- *Nëntori i bardhë (përmbledhje studimore): Vepra e Ndoc Nikajt*, Shkodër, 2015.
- Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare* (155102001), Tiranë-Prishtinë, 1997.


H. *Objektivat e projektit*

*Objektivi i zhvillimit:*

Ky projekt synon të studiojë e të nxjerrë të plotë kontributin gjuhësor, letrar, historik, publicistik të Dom Ndoc Nikajt duke analizuar veprat e këtij autori me qëllim që të vihet re evoluimi i gjuhës që ka përdorur autori. Në vëmendje do të jete edhe kontributi i tij në fushën metodike:

*Objektivat imediate dhe rezultatet e pritshme:*

***Objektivi 1.***

Studimi i punës së N. Nikaj, studim i literaturës. Puna në mbledhjen e materialeve të botuara nga Nikaj dhe literaturës përkatëse që do të shërbejnë si bazë materiale mbi të cilat do të përqendrohet studimi.

***Rezultati 1:*** Krijimi i një baze të detajuar të të dhënave gjuhësore dhe letrare në veprat e N. Nikajt.

***Rezultati 2:*** Krijimi i një baze të detajuar të të dhënave të publicistikës së këtij autori.

***Objektivi 2.***

Kërkimi i dorëshkrimeve të pabotuara të Nikajt në burimet arkivore. Studiuesit e gjuhësisë kanë si qëllim të punës së tyre kërkimin e dorëshkrimeve të pabotuara të autorit pranë bibliotekave të Universitetit, qytetit dhe asaj Françeskane.

***Rezultati 1:*** Skedimi i materialeve, planifikimi i strukturës së monografisë.

***Rezultati 2:*** Secili grup pune do të skedojë materialet nga burimet gjuhësore, letrare dhe publicistike për të arritur në planifikimin e një monografie të vetme të ndarë sipas këtyre disiplinave.

***Objektivi 3.***

Prezantimi i rezultateve studimore, mbajtja e një konference shkencore

***Rezultati 1:*** Përpilim i librit të abstrakteve (LA), Monografisë (Mo) dhe Kolanës (Ko).

***Rezultati 2:*** Botimi i monografisë dhe artikujve të Konferencës shkencore.

I. *Përfituesit nga projekti:*

*Përfituesit direktë:*

Përfituesit direktë do të jenë punonjësit shkencorë të QSA-së, pedagogët e departamentit të Gjuhësisë dhe doktorantët.

*Përfituesit indirektë:*

Specialistët e gjuhës shqipe, studiues, pedagogë, studentë të fushës së gjuhësisë.

J. *Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara (përfshirë patenta, etj.).*

Kontributi specifik që sjell ky projekt është rivlerësimi i një prej figurave të shquara të historisë, kulturës e të arsimit shqiptar, si ajo e N. Nikajt, duke evidentuar dhe plotësuar vlerave kulturore historike i periudhës parapavarësisë.
Ky projekt është një hap i rëndësishëm në integrimin e punës kërkimore e shkencore me procesin mësimor, veçanërisht në programin e studimit "Master shkencor" dhe Doktoraturë në gjuhë shqipe. Një model i tillë studimi do t'i vijë në ndihmë të gjithë studentëve të Masterit Shkencor dhe Doktoraturë në gjuhë shqipe në realizimin e platformave dhe modeleve të studimit për autorë të tjerë të trevës së Veriut që janë prioritet i QSA-së dhe vetë ciklit të tretë që ajo mbikqyr. Në një të ardhme të afërt mendohet që aspirantët për doktorantë të përfshihen në projekte të mëtejshme që kanë të bëjnë me studim e gegërishtes dhe autorëve të Veriut.

K. *Plani i përgjithshëm i punës dhe ai i detajuar, metodologjia dhe teknikat që propozohet të përdoren:*

**Plani i përgjithshëm** :

Rezultati i këtij projekti është një monografi e ndërthurur në disa disiplina të ndryshme, ku secila prej tyre përfaqëson studime të mirëfillta gjuhësore, letrare, dhe publicistike kushtuar figurës shumëdimensionale të Ndoc Nikaj.
Kësaj figure dhe këtij studimi do ti kushtohet një konferencë shkencore ndërkombëtare ku do t'i lihet hapësirë kumtimeve dhe referimeve brenda dhe jashtë vendit për veprën dhe penën e pashoq të Ndoc Nikaj.

***Plani i detajuar*:**

- Vjelja e materialit dhe një analizë në sistemin fonetik, morfologjik e pjesërisht leksikor.
- Analizë dialektore në rrafshin leksikor e sintaksor.
- Studim gjuhësor të veprës së Nikajt: modelet alfabetike në shkrimet e Nikajt (Nikaj si themelues i Shoqërisë"Bashkimi", shoqërisë që krijoi alfabetin e sotëm); tiparet gjuhësore (dukuritë fonetike) në veprat shkollore të N. Nikajt.

*10 muaj.*

- Studim dhe interpretim i figurave femërore në romanin : Bukurusha (1918) edhe në planin gjuhwsor.
- Paralele mes personazhe të tjerë femërorë në letërsi, para dhe pas Nikajt
- Përpilimi i materialit të plotë mbi kontributin shumëplanësh të Nikajt, në publicistikën shqiptare.

*8 muaj*

- Përgatitja për botim e monografisë kushtuar figurës shumëdimesionale të N. Nikajt

*4 muaj*

- Organizimi i një konference shkencore ndërkombëtare

*2 muaj*

L. *Si mendohet t'u bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?*
Nëpërmjet publikimeve shkencore ne lidhje me rezultatet e arritura

## BUXHETI I PROJEKTIT

*Vlerësimi i projektit për vitin e parë në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

A. **Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet:**

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Mimoza Priku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 2. | Zamira Shkreli | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 3. | Alfred Capaliku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 4. | Anisa Kosteri | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 5. | Ermira Alija | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 6 | Bora Logu | 30% | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 7 | Isida Hoxha | 30% | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |

Totali i pjesshëm (A) : **175 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit) –*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| 1. | Udhëtime brenda vendit | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

C.Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

*C.1.Shpenzime për pajisje specifike*

- Shpenzime kapitale

| Nr. | Emërtimi | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|---|---|---|
| *Pajisje Profesionale* | | | | | |
| 1. | | | | | |
| *Të tjera* | | | | | |
| 1. | | | | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë:

***Vlera e plotë e projektit për vitin e parë* : 175 mijë lekë**

*Burimet e financimit të Projektit për vitin e parë të shprehura në %.*

| Burimet e financimit | % | në mijë lekë |
|---|---|---|
| Shuma që do të financohet nga vetë Agjencia Ekzekutuese | 100 % | 175 |
| | | - |

Totali i pjesshëm : **175 mijë lekë/vit**

*Vlerësimi i projektit për vitin e dytë në mijë lekë.*

**Studime fizibiliteti** (Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara).

B. Honorare për përgatitje projekti dhe për studimin që do të kryhet:

A.1. Paga (nga Universiteti i Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*").

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në Projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| | | | | |

A.2. Honorare :

| Personeli i projektit dhe përqindja e kohës së plotë të punës që do të angazhohet në projekt | | | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Koha në % | Paga bazë dhe shtesat | Gjithsej |
| 1. | Mimoza Priku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 2. | Zamira Shkreli | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 3. | Alfred Capaliku | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 4. | Anisa Kosteri | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 5. | Ermira Alija | 30 % | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 6. | Bora Logu | 30% | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| 7. | Isida Hoxha | 30% | 2.5 lekë/muaj x 10 muaj | 25 |
| | | | | |

Totali i pjesshëm (A) : **175 mijë lekë/vit**

*B.1.Shërbime nga të tretët (për nevojat e studimit të fizibilitetit) –*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

*B.2. Shpenzime transporti (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë :

B.3. Shpenzime udhëtimi (për nevojat e studimit të fizibilitetit) (nga USH)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë

*B.4. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (për nevojat e studimit të fizibilitetit)*

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | | |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : -

B.5. Shpenzime të tjera operative (për nevojat e studimit të fizibilitetit)

| Nr. | Emërtimi | Vlerësimi i shpenzimeve në mijë lekë |
|---|---|---|
| | Konferencë shkencore | 50 |

Totali i pjesshëm në mijë lekë : **50 mijë lekë/vit**

| Viti i financ | Honorare studimi (zëri 230) | Shpenz. Udhët. (zëri 230) | Shërb. të tretët (zëri 230) | Shpenz. Transp. (zëri 230) | Shpenz. Të tjera operat. (zëri 230) | Totali (zëri 230) | Pajisje (zëri 231) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti I** | 175 | - | - | - | | 175 | - | 175 |
| **Viti II** | 175 | - | - | - | 50 | 225 | - | 225 |
| **Gjithsej :** | | | | | | | | **400 mijë lekë** |

*11. A është institucioni (Agjensia Ekzekutuese) person juridik?* **Po**

*12. Kur është i përgatitur institucioni të fillojë Projektin?* ***Tetor 2021***

*13. Cilat janë risqet e mundshme dhe si do të kapërcehen?*
Mendojme se nuk ka risqe.

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

Prof. dr. Mimoza PRIKU

Dr. Zamira Shkreli

Firma Data :

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Firma Data :

# VI. Projekt

## “LEKSIKU NË EPIKËN E ATË GJERGJ FISHTËS”

### (“Lahuta e Malcís”, “Mojs Golemi”)

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**
***"Luigj Gurakuqi"***
**Departamenti i Gjuhësisë**

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**
***"Luigj Gurakuqi"***
**Qendra e Studimeve Albanologjike**

**PROJEKT**

# "LEKSIKU NË EPIKËN E ATË GJERGJ FISHTËS"
## ("Lahuta e Malcís", "Mojs Golemi")




A. *Propozuar si pjesë e Programit të kërkimit shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike:* Kjo fushë studimi është përcaktuar si prioritet nga qeveria shqiptare në fushën e kërkimit shkencor *(duke e renditur si fushën e parë te kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit v.2, dt. 11.05.2018)*, propozuar edhe si pjesë e prioriteteve strategjike të USH me Vendimin e SA nr. 97 nr. 1026 prot., datë 29. 03. 2021 ku "Studimet albanologjike" është njëri prejt tyre.
Fusha e Kërkimit shkencor: **Albanologji**

B. *Objektivat e programit të cilave u referohet projekti:*

Projekti ka për qëllim hulumtimin mbi leksikun e *kryeveprës* së Atë Gjergj Fishtës, "Lahuta e Malcís", dhe të poemës "Mojs Golemi", me synim final hartimin e një fjalori shpjegues mbi leksikun e krijimtarisë epike të këtij shkrimtari; një punë kjo shumë e vlefshme nga ana leksikologjike e leksikografike, sidomos në lidhje me shpjegimin e fjalëve të panjohura ose pak të njohura për lexuesit e interesuar sot. Hartimi i një fjalori të tillë sjell gjendjen gjuhësore në periudhën kur shkroi *Poeti ynë Kombëtar*, 100 vite më parë, si dhe shpalos kontributin e tij të vyer në fushën e leksikut, të semantikës e të fjalëformimit për gjuhën shqipe.

C. *Afati :* *Kohëzgjatja:* **2 vjet**

D. Personeli pjesëmarrës në projekt:

| Nr. | Emri | Profesioni dhe kategoria e pagës |
|---|---|---|
| 1. | Prof.as.dr. Orjeta Baja | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 2. | Dr. Merita Hysa | Pedagoge pranë Departamentit të Gjuhësisë |
| 3. | Dr. Erzen Koperaj | Punonjës shkencor pranë QSA |

E. *Argumentimi shkencor i projektit.*

*Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:*

Objekti i kërkimit shkencor do të jetë hartimi i një fjalori të veprës epike të Gjergj Fishtës, duke pasur parasysh vlerësimin e shumë studiuesve mbi *veprën monumentale* "Lahuta e Malcís". Është pranuar se *kryevepra* e Fishtës është shumë e pasur nga ana leksikore, semantike e stilistike. Hartimi i fjalorit të një shkrimtari, si dhe vjelja në mënyrë shteruese e fjalëve të rralla të tij, në këtë rast të Fishtës, po bëhet nxitëse sot pas futjes së gjerë të teknologjive informatike edhe në studimet gjuhësore. Kështu, do të punohet, së pari, për digjitalizimin e veprës epike të Gj. Fishtës, dhe në vijim për listimin, hulumtimin dhe paraqitjen e leksikut në një fjalor, në përputhje me kriteret e nevojshme leksikografike.

- Projekti është i domosdoshëm të ndërmerret, pasi një punim i tillë (fjalor i veçantë) do të mund të shfrytëzohet jo vetëm për studime historiko-gjuhësore, por edhe për fjalorin e mbarë shqipes dhe për fjalorë të tjerë njëgjuhësorë.
- Përmes një fjalori të tillë, historik, të një kryevepre të letërsisë shqiptare, evidentohet e ndriçohet historia e fjalëve të veçanta, e në të njëjtën kohë ndihmesa e Gjergj Fishtës në gjuhën shqipe.
- Rezultatet e këtij kërkimi do të ndihmojnë drejtpërsëdrejti studiuesit për përshkrimin e gjuhës edhe në rrafshin fonetik e morfologjik.
- Ky kërkim shkencor, gjithashtu, synon të përcaktohet në vazhdim me saktësi se ç'sasi leksikore nga gjuha e Fishtës (përmes veprës "Lahuta e Malcís") është përfshirë në FGJSH dhe ç'sasi paraqet lëndë potenciale për t'u bërë pjesë e këtij fjalori.
- Ky punim do të ndihmojë studiuesit që të përcaktohet edhe ç'leksik ka marrë Fishta nga shkrimtarët pararendës.
- Ky fjalor do të zbulonte edhe fjalët e krijuara nga vetë autori ose që paraqiten vetëm në veprën e tij.
- Fjalori, po kështu, do të ndihmonte të shihnim praninë e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, funksionin e tyre dhe ç'vend zënë në vepër.

F. *Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në Departamentin e Gjuhësisë (USH) dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike (USH) (brenda apo jashtë kuadrit të Programeve Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit):*

1. Orjeta Baja, *"Gjuha në Epikën e Fishtës (në nivel stilistik)"* (monografi), Shkodër, 2016.
2. Artan Haxhi, *"Proza e Fishtës në pamje gjuhësore (sistemi foljor)"* (monografi), Shkodër, 2003.
